



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri lëndës: KSC-BC-2020-06

**Prokurori k. Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe
Jakup Krasniqit**

Vendosi: Trupi Gjykues II

Gjykatës Çarls L. Smith III, Kryegjykatës

Gjykatës Kristof Barte

Gjykatës Ginel Metro

Gjykatës Fergal Gejnor, gjykatës rezervë

Administratore:: Fidelma Donlon

Data: 9 qershor 2023

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Konfidencial dhe *ex parte*

**Vendimi i Dytë mbi Mocionin e Prokurorit të Specializuar për Pranimin e Provave
Jogojore**

**Ushtruesit të Detyrës së Prokurorit
të Specializuar**
Aleks Uajting

Mbrojtjes së Jakup Krasniqit
Venkatesvari Alagendra

TRUPI GJYKUES II ("Trupi Gjykues"), në bazë të neneve 21, 40(2) dhe (6)(h) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe rregullave 137 dhe 138(1) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"), lëshon këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 16 dhjetor 2022, Trupi Gjykues ftoi Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("ZPS") të paraqiste një mocion për pranimin e provave jогоjore në lidhje me: (i) provat materiale të propozuara në listën e provave materiale të saj, të cilat synonte t'i përdorte për 40 dëshmitarët e parë të saj; dhe (ii) materialin provues që ZPS-ja e konsideronte të rëndësishëm për paraqitjen e qartë dhe të efektshme të provave të saj në këtë fazë. ("Urdhri i Katërt Gojor").¹
2. Më 8 shkurt 2023, ZPS-ja dorëzoi një kërkesë për pranimin e provave jогоjore ("Mocioni për Pranimin e Provave Jогоjore").²
3. Më 21 shkurt 2023, Trupi Gjykues, me kërkesë të Mbrojtjes së Hashim Thaçit ("z. Thaçi"), Kadri Veselit ("z. Veseli"), Rexhep Selimit ("z. Selimi") dhe Jakup Krasniqit ("z. Krasniqi") (bashkërisht, "të akuzuarit" dhe "Mbrojtja"), zgjati afatin për përgjigjen ndaj Mocionit për Pranimin e Provave Jогоjore deri më 21 mars 2023.³

¹ Transkripti i seancës, Trupi Gjykues, 16 dhjetor 2022, f. 1775, rreshti 6 deri në f. 1776, rreshti 5.

² F01268, Prokurori i Specializuar, *Kërkesë e Prokurorisë për Pranimin e Provave Jогоjore*, 8 shkurt 2023, me Shtojcat 1-4, 6 dhe 7, konfidenciale dhe me Shtojcat 5 dhe 8.

³ F01309, Trupi Gjykues, *Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes për Mocion të Rishikuar për Provat Jогоjore dhe Pezullim dhe Zgjatje Afati*, 21 shkurt 2023, para. 15, 16(c).

4. Më 21 mars 2023, Mbrojtja iu përgjigj Mocionit për Pranimin e Provave Jogojore ("Përgjigja").⁴

5. Më 31 mars 2023, Trupi Gjykues lëshoi vendimin për pranimin e një numri dokumentesh të paraqitura në Mocionin për Pranimin e Provave Jogojore ("Vendimi mbi Mocionin për Pranimin e Provave Jogojore").⁵

II. PARASHTRIMET

6. ZPS-ja kërkon pranimin si prova jogojore të materialeve të ndara në gjashtë kategori: (i) komunikata, deklarata politike dhe njoftime të tjera të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ("UÇK"); (ii) versione pune të deklarave publike të UÇK-së, të sekuestruara në shtëpinë e z. Krasniqi; (iii) materiale arkivore të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së të botuara nga agjencia mediatike Radio Kosova e Lirë ("RKL"); (iv) materiale arkivore të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së të botuara nga agjencia Kosovapress; (v) ribotime në media të tjera të materialeve të botuara nga agjencia Kosovapress; dhe (vi) materiale të tjera që nuk përfshihen në një kategori konkrete, por që janë brenda fushëveprimit të Urdhrit të Katërt Gojor.⁶

7. Mbrojtja përgjigjet se Mocioni për Pranimin e Provave Jogojore është një orvatje e paarsyeshme dhe cenuese për pranimin e një volumi shumë të madh provash, e cila shmang shqyrtimin e drejtë dhe kriteret sipas të cilave vlerësimi i vërtetësisë së dokumenteve dhe verifikimi i tyre duhet të bëhet përmes paraqitjes së tyre nga dëshmitarët përkatës.⁷ Mbrojtja parashtron se ZPS-ja nuk ka zbatuar udhëzimin e Trupit Gjykues për përdorimin e një standardi të lartë vlerësimi për

⁴ F01387, Mbrojtja, *Përgjigje e Përbashkët e Mbrojtjes ndaj Kërkesës së Prokurorisë për Pranimin e Provave Jogojore*, 21 mars 2023, konfidenciale, me Shtojcat 1-8, konfidenciale.

⁵ F01409, Trupi Gjykues, *Vendim mbi Mocionin e Prokurorit të Specializuar për Pranimin e Provave Jogojore*, 31 mars 2023, konfidencial.

⁶ Mocioni për Pranimin e Provave Jogojore, para. 2.

⁷ Përgjigja, para. 1.

të siguruar paraqitjen vetëm të provave me vlerë të lartë provuese.⁸ Mbrojtja shton se kjo qasje do të krijojë një dokumentacion të fryrë të çështjes gjyqësore dhe do të cenojë drejtësinë e procesit, duke anashkaluar ndjeshëm parimet udhëzuese të paraqitjes së dëshmive gojore, gjykimit publik dhe paraqitjes së argumenteve ballafaqese, çka nuk do ta përshpejtojë gjykimin dhe as do të mundësojë gjykim të drejtë të çështjes.⁹ Gjithashtu, Mbrojtja ngre kundërshtime të përgjithshme lidhur me pranimin si prova jogojore të 13 kategorive të ndryshme të provave dokumentare dhe ngre kundërshtime të tjera konkrete lidhur me një sërë materialesh të tjera.¹⁰

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

8. Dispozitat ligjore në lidhje me këtë temë përcaktohen në nenin 40(6)(h) dhe rregullën 138(1), dhe janë shtjelluar gjerësisht në Vendimin mbi Mocionin për Pranimin e Provave Jogojore.¹¹ Trupi Gjykses do të zbatojë në këtë vendim standardet e përcaktuara në to.

IV. DISKUTIM

A. ASPEKTE PARAPRAKE

9. Trupi Gjykses thekson se në Vendimin mbi Mocionin për Pranimin e Provave Jogojore, ai u dha përparësi atyre materialeve të cilat ZPS-ja i ka evidentuar si materiale që lidhen me gjashtë dëshmitarët e parë të propozuar prej saj. Vendimi aktual e plotëson atë vendim duke trajtuar ato materiale të cilat ZPS-ja i ka evidentuar si materiale që lidhen me W04746-ën, W01236-ën dhe W04290-n.¹² Nuk

⁸ Përgjigjja, para. 3.

⁹ Përgjigjja, para. 4.

¹⁰ Përgjigjja, para. 14-105; Shtojcat 1-6 të Përgjigjes.

¹¹ *Shih* Vendimin mbi Mocionin për Pranimin e Provave Jogojore, para. 8-13.

¹² F01243/A01, Prokurori i Specializuar, *Shtojca 1 e Parashtrimit të Listës së 12 Dëshmitarëve të Parë të Prokurorisë dhe Informacionit në lidhje me Ta*, 1 shkurt 2023, konfidenciale, f. 15-33.

ka materiale, apo vetëm kopje materialesh, të evidentuara si materiale që lidhen me W04323-shin, W04337-ën dhe W03165-ën dhe, për rrjedhojë, dokumentet që kanë lidhje me këta dëshmitarë, nuk do të trajtohen.

10. Trupi Gjykses vëren se ndonëse materialet SPOE00053729-SPOE00053730-ET¹³ dhe SPOE00053796-SPOE00053797-ET¹⁴ janë evidentuar si materiale që lidhen me W04290-n, Trupi Gjykses shtyn vendimin e tij në lidhje me këto dy materiale dhe do ta japë atë në kuadër të vendimit të ardhshëm mbi provat jогоjore.

11. Trupi Gjykses gjithashtu vë në dukje se është konstatuar se tri dokumente janë të përshtatshme për pranim sipas rregullës 154 si “prova materiale shoqëruese”,¹⁵ dhe se një prej këtyre dokumenteve është pranuar më pas si provë.¹⁶ Për arsyet e specifikuar në Vendimin mbi Mocionin për Pranimin e Provave Jогоjore,¹⁷ kërkesa për pranimin e tyre si prova jогоjore është e tejkaluar.

B. KATEGORITË E PROVAVE TË PROPOZUARA

12. Trupi Gjykses tani do të trajtojë kërkesën e ZPS-së për pranimin si prova jогоjore të materialeve të cilat ZPS-ja synon t’i përdorë me W04746-ën, W01236-ën dhe W04290-n. Trupi Gjykses ka bërë vlerësimin e këtyre materialeve sipas kategorive të mëposhtme: (i) fotografi dhe videoincizime; (ii) libra; (iii) raporte në shtyp, artikuj të gazetave dhe intervista; (iv) dekrete dhe komunikata të publikuara në RKL dhe “Kosovapress”; (v) dokumente zyrtare të organizatave; (vi) dokumente që lidhen me UÇK-në; dhe (vii) dokumente të sekuestruara në shtëpitë e z. Krasniqi ose z. Selimi.

¹³ *Shih* Shtojcën 4 të Mocionit për Pranimin e Provave Jогоjore, materialin 1A2.

¹⁴ *Shih* Shtojcën 4 të Mocionit për Pranimin e Provave Jогоjore, materiali 1I2.

¹⁵ **W04746**: SPOE00330390-00330391, SPOE00198098-00198366 dhe IT-05-87 P00456; *Shih* Shtojcën 6 të Mocionit për Pranimin e Provave Jогоjore, materialet 197, 203, 335; *Shih gjithashtu* Vendimin sipas Rregullës 154, para. 85, 92, 95, poshtëshënimin 158.

¹⁶ *Shih* 1D00007.

¹⁷ *Shih gjithashtu* Vendimin mbi Mocionin për Pranimin e Provave Jогоjore, para. 21.

1. Kategoria 1: Fotografi dhe videoincizime

13. ZPS-ja kërkon pranimin si prova jogojore të tri fotografive dhe një videoincizimi.¹⁸ ZPS-ja parashtron se këto fotografi dhe videoincizimi janë autentikë, me vlerë provuese dhe se pranimi i tyre nuk dëmton në mënyrë të papërligjur Mbrojtjen.¹⁹

14. Mbrojtja kundërshton pranimin si prova jogojore të fotografive dhe videoincizimeve të shumta, pasi shumë prej tyre janë bërë nga dëshmitarë të ZPS-së ose kanë lidhje me ta dhe, për rrjedhojë, duhet të paraqiten përmes dëshmitarëve përkatës. Mbrojtja parashtron se jurisprudenca e krijuar përcakton se fotografitë dhe videoincizimet nuk duhet të pranohen si prova jogojore, pa paraqitjen e provave të pavarura dhe të pranueshme.²⁰

15. Trupi Gjykues vlerëson se në mungesë të hollësive të mëtejshme, si data, vendi, ose elementeve të tjera kontekstuale, të dhëna nga dëshmitari, relevanca e fotografive të të akuzuarve, W04290-s dhe të tjerëve, është e paqartë. Gjithashtu, Trupi Gjykues vlerëson se nuk mund të konstatohet relevanca e videoincizimit, pa i dhënë kontekst të mëtejshëm. Rrjedhimisht, Trupi Gjykues nuk do t'i pranojë si prova jogojore tri fotografitë dhe videoincizimin.

16. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykues refuzon pranimin si prova jogojore të materialeve 058755-058755, SPOE00204138-00204138, IT-03-66 P248 dhe 054774-01.

2. Kategoria 2: Libra

17. ZPS-ja kërkon pranimin si prova jogojore, në tërësi ose si pjesë të shkëputura, të materialeve në vijim²¹: (i) librit “Libri i Luftës” të Nuhi Bytyçit, në të cilin ai sjell

¹⁸ W04290: 058755-058755, SPOE00204138-00204138, IT-03-66 P248 dhe 054774-01; *Shih* Shtojcën 6 të Mocionit për Pranimin e Provave Jogojore, materialet 334, 512, 613, 622.

¹⁹ Mocioni për Pranimin e Provave Jogojore, para. 3.

²⁰ Përgjigjja, para. 95-96; Shtojca 6.8 e Përgjigjes, f. 2-3, 7-8, 34, 36.

²¹ Trupi Gjykues thekson se të gjitha referencat për materiale në këtë vendim përfshijnë edhe përkthimet e tyre përkatëse, përveç nëse përcaktohet ndryshe.

kujtimet e tij nga koha kur punonte si gazetar gjatë konfliktit;²² (ii) librit “Ushtria Çlirimtare e Kosovës – Zona Operative e Llapit” të Skënder Zhitisë, që përmban informacion të marrë nga arkivat e UÇK-së dhe intervista me anëtarë të saj;²³ (iii) librit “Lufta për Kosovën: Flet Komandant Remi” të Safet Zejnullahut, që përmban seanca me pyetje dhe përgjigje të zhvilluara ndërmjet autorit dhe W04746-ës lidhur me konfliktin;²⁴ (iv) një libri të botuar nga z. Krasniqi;²⁵ dhe (v) një fragmenti të shkëputur nga libri me titull “Gerilja Reporteren” të Pal Refsdal.²⁶ ZPS-ja parashtron se këto materiale janë relevante, autentike dhe me vlerë provuese dhe se pranimi i tyre nuk dëmton në mënyrë të papërligjur Mbrojtjen.²⁷

18. Mbrojtja kundërshton pranimin si prova jogojore të këtyre librave.²⁸ Mbrojtja parashtron se librave të paraqitur u mungon besueshmëria *prima facie*, pasi, në masë të madhe, ato bazohen në informacione të dorës së dytë, të marra nga palë të treta, të cilat nuk mund të pyeten drejtpërdrejt nga Mbrojtja.²⁹ Mbrojtja shton se ZPS-ja nuk ka demonstruar me qartësi se në çfarë aspekti dhe në çfarë mënyre këta libra të ndryshëm janë bërë pjesë e provave dhe argumenteve të saj dhe se ZPS-ja kërkon pranimin si prova jogojore të këtyre librave voluminozë, pa evidentuar në to pjesët relevante.³⁰

²² W04746: SPOE00128571-00128954; *Shih* Shtojcën 6 të Mocionit për Pranimin e Provave Jogojore, materialin 336.

²³ W04746: SPOE00055678-00056018; *Shih* Shtojcën 6 të Mocionit për Pranimin e Provave Jogojore, materialin 395.

²⁴ W04746: SPOE00053263-00053359; *Shih* Shtojcën 6 të Mocionit për Pranimin e Provave Jogojore, materialin 415.

²⁵ W04290: U015-8743-U015-9047; *Shih* Shtojcën 6 të Mocionit për Pranimin e Provave Jogojore, materialin 9.

²⁶ W04290: SPOE00209434 -00209512; *Shih* Shtojcën 6 të Mocionit për Pranimin e Provave Jogojore, materialin 329.

²⁷ Mocioni për Pranimin e Provave Jogojore, para. 3.

²⁸ Përgjigjja, para. 68; Shtojca 6.4 e Përgjigjes, f. 1-16.

²⁹ Përgjigjja, para. 69.

³⁰ Përgjigjja, para. 70.

19. Fillimisht, Trupi Gjykses thekson se Nuhi Bytyçi, autor i librit “Libri i Luftës”, është dëshmitar i ZPS-së.³¹ Rrjedhimisht, Trupi Gjykses është i mendimit se do të ishte e parakohshme të pranohej kjo provë e propozuar para se të dëgjohej vetë autori i saj.

20. Lidhur me relevancën e materialeve SPOE00055678-00056018, SPOE00053263-00053359 dhe U015-8743-U015-9047, Trupi Gjykses vëren se ZPS-ja ka cituar pjesë të këtyre materialeve në dosjen paraprake të saj (“Dosja Paraprake”).³² Këto pjesë janë relevante, pasi në to trajtohen, ndër të tjera, struktura dhe funksionimi i UÇK-së, mjetet dhe metodat e komunikimit brenda UÇK-së, veprimet konkrete të kryera në zonat operative të evidentuara në aktakuzë dhe nxjerrja prej UÇK-së e rregulloreve politike.³³ Sa i përket materialit SPOE00209434-00209512, ndonëse ai nuk përmendet në Dosjen Paraprake, Trupi Gjykses gjykon se ai është me rëndësi për praninë e të akuzuarve në vende të ndryshme dhe mjetet e komunikimit në dispozicion të të akuzuarve.

21. Në lidhje me autenticitetin, Trupi Gjykses vlerëson se materialet SPOE00055678-00056018, SPOE00053263-00053359, U015-8743-U015-9047 dhe SPOE00209434-00209512 janë *prima facie* autentike, pasi janë libra të botuar.

22. Sidoqoftë, Trupi Gjykses nuk është bindur se është vërtetuar besueshmëria *prima facie* e materialit SPOE00209434-00209512. Burimi i informacionit që përmban libri, është i paqartë dhe autori i tij nuk do të thirret si dëshmitar, çka e bën të vështirë për Mbrojtjen të verifikojë këtë provë dhe për Trupin Gjykses të

³¹ Shih F01296/A02, Prokurori i Specializuar, *Shtojca 2 e Parashtrimeve të Prokurorisë në përputhje me Vendimin F01229*, 15 shkurt 2023, konfidenciale, f. 12.

³² F00709/A02, Prokurori i Specializuar, *Shtojca 2 e Parashtrimit të Dosjes Paraprake të Korrigjuar të Prokurorisë dhe të Kërkesave në lidhje me Të*, 24 shkurt 2022, konfidenciale, (versioni konfidencial me më pak redaktime u dorëzua më 15 shkurt 2023, F01296/A01) para. 25 (ku citohet f. U015-8782), 58 (ku citohet f. U015-8758), 111 (ku citohet f. U015-8878), 179 (ku citohet f. U015-8757), 203-213 (ku citohen f. SPOE00055805, SPOE00055810, SPOE00055849 dhe SPOE00055911) 216 (ku citohet f. SPOE00053322), 251 (ku citohet U015-8876), 254 (ku citohet f. U015-8874-U015-8876).

³³ Shih më lart, poshtëshënimin 32; Shih gjithashtu F00999/A01, *Parashtrim i Aktakuzës së Konfirmuar të Ndryshuar* (“Aktakuza”), 30 shtator 2022, konfidencial, para. 19, 53.

vlerësojë mbështetshmërinë e saj. Rrjedhimisht, Trupi Gjykues nuk do ta pranojë këtë material si provë jogojore.

23. Trupi Gjykues është bindur për besueshmërinë dhe vlerën provuese *prima facie* të materialit U015-8743-U015-9047. Ky material ka për autor z. Krasniqi e është publikuar prej tij, kurse në të trajtohen temat e evidentuara më lart.³⁴ Trupi Gjykues është po kështu bindur për vlerën provuese *prima facie* të materialeve SPOE00055678-00056018 dhe SPOE00053263-00053359, duke pasur parasysh burimin dhe përmbajtjen e tyre.

24. Ndonëse ZPS-ja mbështetet në pjesë të materialeve SPOE00055678-00056018, SPOE00053263-00053359 dhe U015-8743-U015-9047 në shumë pjesë të Dosjes Paraprake të saj,³⁵ Trupi Gjykues nuk është i bindur se pranimi në tërësi i librave, është i përligjur. Rrjedhimisht, fjala aktualisht është vetëm për pranimin e atyre faqeve të librave dhe të përkthimeve të tyre në gjuhën angleze, të cilat ZPS-ja i ka evidentuar në dosjen paraprake si relevante për argumentet dhe provat e saj.³⁶ Në qoftë se ZPS-ja kërkon të pranohet si provë ndonjë faqe tjetër apo faqe të tjera të këtyre librave, ajo duhet të dorëzojë një kërkesë të re për këtë qëllim në lidhje me faqen/faqet ose pjesën/pjesët përkatëse, dhe të shpjegojë relevancën e tyre për argumentet dhe provat e saj.

25. Lidhur me aspektin nëse vlера provuese e këtyre faqeve të materialeve SPOE00055678-00056018, SPOE00053263-00053359 dhe U015-8743-U015-9047 zhbëhet prej efektit dëmtues të tyre, Trupi Gjykues thekson se ndonëse disa pjesë të librave përmbajnë materiale që nuk u dihet burimi, dhe/ose informacion të dorës së dytë nga burime të paidentifikueshme, Trupi Gjykues mund t'i trajtojë këto probleme duke përcaktuar peshën e saktë që kanë këto pjesë të librave dhe/ose duke shpërfillur ato pretendime ose parashtrime që janë të pabaza.

³⁴ Shih më lart, paragrafin 20.

³⁵ Shih më lart, poshtëshënimin 32.

³⁶ Shih më lart, poshtëshënimin 32.

Gjithashtu, siç thekson Mbrojtja në parashtrimet e saj, ZPS-ja synon të thërrasë shumë dëshmitarë të cilët mund t'i japin kontekst informacionit që gjendet në këta libra.³⁷ Rrjedhimisht, Mbrojtja do të ketë mundësi të kundërshtojë aspekte të informacionit të përfshirë në pjesët e pranuara, përmes marrjes në pyetje të dëshmitarëve të ZPS-së.

26. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykues pranon si prova jोगore materialet SPOE00055678-00056018 (f. SPOE00055805, SPOE00055810, SPOE00055849 dhe SPOE00055911), SPOE00053263-00053359 (f. SPOE00053322) dhe U015-8743-U015-9047 (f. U015-8757-U015-8758, U015-8782, U015-8874-U015-8876 dhe U015-8878). Trupi Gjykues nuk pranon si prova jोगore materialet SPOE00209434-00209512 dhe SPOE00128571-00128954 në tërësi si dhe pjesët e mbetura të materialeve SPOE00055678-00056018, SPOE00053263-00053359 dhe U015-8743-U015-9047.

3. Kategoria 3: Raporte në shtyp, artikuj në gazeta dhe intervista

27. ZPS-ja kërkon pranimin si prova jोगore të 14 materialeve, konkretisht: (i) tri materialeve të publikuara nga arkivat e RKL-së dhe agjencisë "Kosovapress", të cilat përmbajnë informacion ose deklarata që i atribuohen W04746-ës dhe/ose të akuzuarve;³⁸ (ii) tre artikujve që janë intervista me W04290-n të botuara në gazetën "Zëri i Kosovës";³⁹ (iii) pesë artikujve të botuar në gazetën "Washington Post", "Zëri i Kosovës", dhe në përgjigje të një artikulli të botuar në gazetën "Zëri i Kosovës", të cilët, ndër të tjera, përmbajnë deklarata që i atribuohen UÇK-së ose

³⁷ Përgjigja, para. 63.

³⁸ **W04746:** SPOE00054318-SPOE00054320, SPOE00054513-SPOE00054514 dhe SPOE00054878-SPOE00054879; *Shih* Shtojcën 4 të Mocionit për Pranimin e Provave Jोगore, materialet 2H, 2M, 3G.

³⁹ **W04290:** 043853-043854, IT-05-87 6D00067 dhe SPOE00230134-SPOE00230134; *Shih* Shtojcën 6 të Mocionit për Pranimin e Provave Jोगore, materialet 231, 498, 630.

të akuzuarve;⁴⁰ (iv) dy artikujve ku shtjellohet natyra e luftës speciale;⁴¹ dhe (v) një artikulli ku trajtohet emërimi prej z. Thaçi i W04746-ës si këshilltar në vitin 2019.⁴² ZPS-ja parashtrohet se këto dokumente janë relevante, autentike dhe me vlerë provuese dhe se pranimi i tyre nuk dëmton në mënyrë të papërligjur Mbrojtjen.⁴³

28. Mbrojtja kundërshton pranimin si prova jोगोore të intervistave ndërmjet dëshmitarëve të ZPS-së dhe palëve të treta. Mbrojtja parashtrohet se rreziku që këto materiale të jenë bërë objekt i analizës apo interpretimit nga ana e gazetarëve, apo të jenë manipuluar në ndonjë mënyrë tjetër, shtron nevojën që të akuzuarit t'i jepet mundësia të verifikojnë vërtetësinë e përmbajtjes së tyre.⁴⁴ Mbrojtja shton se ZPS-ja ka pasur mundësinë t'i pyesë dëshmitarët në lidhje me këto intervista gjatë intervistave të saj me ta dhe se këtyre intervistave duhet t'u jepet peshë e vogël provuese në çdo rast që ZPS-ja nuk e ka bërë këtë.⁴⁵

29. Mbrojtja gjithashtu kundërshton pranimin si prova jोगोore të artikujve të botuar në media, ku të akuzuarve ose UÇK-së u atribuohen deklarata, për shkak të pamundësisë së Mbrojtjes për të bërë pyetje në lidhje me këto deklarata të bëra jashtë sallës së gjyqit dhe rrethanat në të cilat janë bërë ato. Mbrojtja shton se pranimi si prova jोगोore i këtyre deklaratave të dorës së dytë ka shumë të ngjarë të shkaktojë dëm të papërligjur, pasi ato u atribuohen figurave me rëndësi qendrore në këtë çështje.⁴⁶ Mbrojtja parashtrohet se, në shumë raste, këto deklarata ishin bërë për qëllime të tjera, si ngritja e moralit të UÇK-së, fitimi i mbështetjes ndërkombëtare, dhënia e sigurisë popullatës civile të frikësuar dhe të cenueshme

⁴⁰ **W04290:** SITF00437747-00437748, SITF00243018-00243022, SITF00243005-00243010, SITF00242993-00242999 dhe 055828-055829; *Shih* Shtojcën 6 të Mocionit për Pranimin e Provave Jोगोore, materialet 421, 438, 440, 444, 621.

⁴¹ **W04746:** SPOE00056463-SPOE00056463 dhe SPOE00056447-SPOE00056447; *Shih* Shtojcën 6 të Mocionit për Pranimin e Provave Jोगोore, materialet 390 dhe 392.

⁴² **W04746:** 076701-076704; *Shih* Shtojcën 6 të Mocionit për Pranimin e Provave Jोगोore, materialin 550.

⁴³ Mocioni për Pranimin e Provave Jोगोore, para. 3.

⁴⁴ Përgjigjja, para. 56.

⁴⁵ Përgjigjja, para. 57; *Shih gjithashtu*; Shtojcën 4 të Përgjigjes, f. 30-31, 39-41, 72-73, 76-77, 90-91; Shtojcën 6.1 të Përgjigjes, f. 84-85; Shtojcën 6.3 të Përgjigjes, f. 5-6, 12-17, 20-21; Shtojcën 6.11 të Përgjigjes, f. 3-6.

⁴⁶ Përgjigjja, para. 59.

dhe vetëpromovimi. Mbrojtja parashtrohet se pa dëshmitarin që sqaron saktësinë e këtyre deklaratave, ato nuk mund të konsiderohen si deklarata në të cilat mund të mbështetesh dhe nuk duhet të pranohen si prova jogojore.⁴⁷

30. Në përgjithësi, që raportet në shtyp, artikujt në gazeta dhe intervistat të jenë të pranueshme si prova jogojore, kërkohet që materiali, në pamje të parë, të ketë tregues të mjaftueshëm për burimin dhe autenticitetin *prima facie* të tij, si dhe që pala që e paraqet të ketë shpjeguar vlerën provuese të materialit (përfshirë mbështetshmërinë).⁴⁸ Fakti që autori i një dokumenti nuk mund të identifikohet, nuk e bën të papranueshëm atë. Po kështu, fakti që informacionit të përfshirë në të mund të mos i dihet burimi, nuk e bën atë domosdoshmërisht të papranueshëm. Megjithatë, nëse pranohet, këta elementë kërkojnë kujdes kur vlerësohet pesha që duhet t'i jepet materialit, nëse ka.⁴⁹

31. Trupi Gjyqësor thekson se do të marrë parasysh materialin 008555-008555-ET, pavarësisht se ZPS-ja nuk ka parashtuar se ky material lidhet me ndonjë dëshmitar për të cilin flitet në këtë vendim. Materiali 008555-008555-ET është një kronikë lajmesh e transmetuar nga RKL-ja, pak kohë pas publikimit të materialit SPOE00054878-SPOE00054879 - një artikull në të cilin denoncohej Bujar Bukoshi. Duke qenë se në këto materiale përdoret e njëjta gjuhë apo një gjuhë e ngjashme, Trupi Gjyqësor gjykon se këto materiale janë të lidhura ngushtë dhe marrja parasysh e materialit është e përligjur.

⁴⁷ Përgjigjja, para. 60.

⁴⁸ KSC-BC-2020-07, F00334, Trupi Gjyqësor II, [Decision on the Prosecution Request for Admission of Items Through the Bar Table](#) (Vendim në lidhje me Kërkesën e Prokurorisë për Pranimin e Provave Jogojore), 29 shtator 2021, para. 31-35, 39-41; ICTY, *Prosecutor v. Ratko Mladić*, IT-09-92-T, Trial Chamber I, [Decision on Defence's Fifth Motion for the Admission of Documents from the Bar Table](#), 30 May 2016, paras 13-15; *Prosecutor v. Ratko Mladić*, IT-09-92-T, Trial Chamber I, [Decision on Prosecution Motion for Admission of Documents from the Bar Table \(Military and Residual Documents\)](#), 13 February 2014, paras 16-17.

⁴⁹ International Criminal Court, *Prosecutor v Bemba Gombo*, ICC-01/05-01/08-2721, Trial Chamber III, [Decision on the Admission into Evidence of Items Deferred in the Chamber's Decision on the Prosecution's Application for Admission of Materials into Evidence Pursuant to Article 64\(9\) of the Rome Statute](#) (ICC-01/05-01/08-2299), 27 June 2013, para. 25.

32. Trupi Gjykues vlerëson se një numër i materialeve të lartpërmendura përfshijnë deklarata në lidhje me zonat operative të Drenicës dhe të Llapit, artikuj për W04290-n dhe intervista me të, dhe deklarata publike që u atribuohen të akuzuarve, të cilat janë relevante, ndër të tjera, sa i përket: (i) dijenisë së Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së për ngjarjet në zonat operative të Drenicës dhe Llapit; (ii) pretendimit për shënjestrim nga UÇK-ja të personave që konsideroheshin si kundërshtarë; (iii) lidhjes së W04290-s me z. Selimi; dhe (iv) strukturës dhe organizimit të UÇK-së.⁵⁰ Lidhur me artikullin dhe kronikën e transmetuar në RKL ku denoncohej Bujar Bukoshi, materialet janë relevante sepse në to përshkruhet politika që pretendohet se zbatonte UÇK-ja ndaj atyre që ishin kundër planeve të saj.⁵¹

33. Lidhur me dy artikujt që kanë të bëjnë me “luftën speciale”, Trupi Gjykues thekson si vijon. Në artikullin e parë shtjellohen pikëpamjet e UÇK-së për përdorimin e luftës speciale dhe efektin e saj, çka bën që ky artikull të jetë relevant për procesin.⁵² Në artikullin e dytë trajtohet lufta psikologjike nga një këndvështrim historik dhe tregohet se si është përdorur ajo në konflikte të ndryshme nga viti 1877 deri në vitin 1974.⁵³ Në të duket qartë se nuk flitet për UÇK-në apo për ngjarjet që kanë ndodhur brenda juridiksionit kohor të këtij procesi gjyqësor. Ndonëse ky artikull duket se përmban të njëjtat formulime të përgjithshme si ato që gjenden në një pjesë të materialit U002-2800-U002-2822,⁵⁴ i cili gjithashtu është paraqitur për t’u pranuar si provë jogojore, kjo nuk ndreq

⁵⁰ Aktakuza, para. 35-40, 62, 99.

⁵¹ SPOE00054878-SPOE00054879 dhe 008555-008555-ET; *Shih* Shtojcën 4 të Mocionit për Pranimin e Provave Jogojore, materialin 3G; Shtojcën 3 të Mocionit për Pranimin e Provave Jogojore, materialin 1B3

⁵² SPOE00056463-SPOE00056463; *Shih* Shtojcën 6 të Mocionit për Pranimin e Provave Jogojore, materialin 390.

⁵³ SPOE00056447-SPOE00056447; *Shih* Shtojcën 6 të Mocionit për Pranimin e Provave Jogojore, materialin 392.

⁵⁴ *Shih* f. U002-2803 deri U002-2806.

mungesën e lidhjes së dukshme të tij me çështjen aktuale. Rrjedhimisht, ZPS-ja nuk ka vërtetuar se ky artikull është relevant për këtë proces gjyqësor.

34. Sa i përket artikullit në të cilin trajtohet emërimi nga z. Thaçi i W04746-ës në rolin e këshilltarit,⁵⁵ ZPS-ja nuk ka vërtetuar relevancën e tij me çështjen aktuale. Dokumenti mund të bëhet relevant në kontekstin e dëshmisë së W04746-ës. Megjithatë, në këtë fazë, nuk është treguar se ai ka lidhje me një fakt apo aspekt thelbësor për çështjen.

35. Në lidhje me autenticitetin, Trupi Gjyqës gjykon se të gjitha materialet e lartpërmendura të vlerësuara si relevante, janë *prima facie* autentike, pasi kanë data, numra dhe vijnë nga arkivat e RKL-së dhe gazetës “Kosovapress” dhe/ose janë publikuar në gazeta zyrtare, si gazeta “Zëri i Kosovës”.

36. Megjithatë, Trupi Gjyqës vlerëson se materialeve 043853-043854, IT-05-87 6D00067, SPOE00230134-SPOE00230134, SITF00437747-00437748, SITF00243018-00243022, SITF00243005-00243010, SITF00242993-00242999 dhe 055828-055829, pa u dhënë kontekst të mëtjshëm nga dëshmitari, u mungon vlera provuese *prima facie*. Së pari, Trupi Gjyqës gjykon se vlera provuese *prima facie* e artikujve për W04290-n ose e intervistave me të,⁵⁶ mund të përcaktohet më saktë përmes dhënies së dëshmisë nga dëshmitari, që mund t’i japë kontekst përmbajtjes së tyre. Së dyti, ZPS-ja nuk ka vërtetuar vlerën provuese të disa materialeve që përmbajnë deklaratat që u atribuohen të akuzuarve.⁵⁷ Trupi Gjyqës vlerëson se besueshmëria *prima facie* dhe vlera provuese e këtyre materialeve mbetet e paqartë dhe se pranimi i tyre në këtë fazë, pa u dhënë kontekst të mëtjshëm, do të krijonte probleme të ballafaqimit dhe do të cenonte në mënyrë të papërligjur të akuzuarit.

⁵⁵ 076701-076704; *Shih* Shtojcën 6 të Mocionit për Pranimin e Provave Jogojore, materialin 550.

⁵⁶ **W04290**: 043853-043854, IT-05-87 6D00067 dhe SPOE00230134-SPOE00230134; *Shih* Shtojcën 6 të Mocionit për Pranimin e Provave Jogojore, materialet 231, 498, 630.

⁵⁷ *Shih më lart*, poshtëshënimin 40.

37. Trupi Gjykses është bindur për vlerën provuese *prima facie* të materialeve SPOE00056463-SPOE00056463, SPOE00054318-SPOE00054320 dhe SPOE00054513-SPOE00054514.⁵⁸ Këto materiale ofrojnë informacion lidhur me operacionet e UÇK-së dhe përdorimin e propagandës, mesazheve dhe komunikatave. Gjithashtu, vlera provuese e tyre rritet kur merret parasysh përmbajtja e tyre si një e tërë.

38. Artikulli dhe transmetimi në radio ku denoncohet Bujar Bukoshi⁵⁹ kanë vlerë provuese *prima facie*, pasi ato janë materiale të publikuara në të cilat trajtohet se me çfarë syri shikoheshin ata që UÇK-ja i konsideronte armiq. Ka një përputhshmëri të ndërsjellë konfirmuese ndërmjet përmbajtjes së materialit SPOE00054878-SPOE00054879 dhe të materialit 008555-008555-ET sa i takon gjuhës së përdorur dhe arsyeve të cituara në denoncimet për Bujar Bukoshin, çka vërteton edhe më shumë vlerën provuese *prima facie* përkatëse të tyre.

39. Sa i përket cenimit të Mbrojtjes, Trupi Gjykses është bindur se vlera provuese e materialeve SPOE00056463-SPOE00056463, SPOE00054513-SPOE00054514, SPOE00054318-SPOE00054320, SPOE00054878-SPOE00054879 dhe 008555-008555-ET nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të tyre ndaj të akuzuarve, pasi Mbrojtja do të ketë mundësinë të kundërshtojë përmbajtjen e këtyre materialeve, përmes marrjes në pyetje, ndër të tjerë, të W04290-s dhe W04746-ës. Trupi Gjykses nuk ka konstatuar rrethana të tjera që sugjerojnë se me pranimin e këtyre dokumenteve do të shkaktohej ndonjë efekt dëmtues.

40. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses pranon si prova jोगojore materialet SPOE00056463-SPOE00056463, SPOE00054513-SPOE00054514, SPOE00054318-SPOE00054320, SPOE00054878-SPOE00054879 dhe 008555-008555-ET dhe refuzon

⁵⁸ *Shih* Shtojcën 4 të Mocionit për Pranimin e Provave Jोगojore, materialet 2H dhe 2M; Shtojcën 6 të Mocionit për Pranimin e Provave Jोगojore, materialin 390.

⁵⁹ SPOE00054878-SPOE00054879 dhe 008555-008555-ET; *Shih* Shtojcën 4 të Mocionit për Pranimin e Provave Jोगojore, materialin 3G dhe Shtojcën 3 të Mocionit për Pranimin e Provave Jोगojore, materialin 1B3.

pranimin si prova jogojore të materialeve SITF00437747-00437748, SPOE00230134-SPOE00230134, SITF00243018-00243022, SITF00243005-00243010, SITF00242993-00242999, IT-05-87 6D00067, 055828-055829, 043853-043854, SPOE00056447-SPOE00056447 dhe 076701-076704.

4. Kategoria 4: Dekrete dhe komunikata të publikuara në RKL dhe Kosovapress

41. ZPS-ja kërkon pranimin si prova jogojore të (i) dekreteve të Qeverisë së Përkohshme të Kosovës;⁶⁰ dhe (ii) një komunikate të lëshuar nga shtabi i zonës operative të Drenicës, e cila buron nga arkivat e publikuara të RKL-së dhe agjencisë Kosovapress.⁶¹ ZPS-ja parashtrohet se këto dokumente janë relevante, autentike dhe me vlerë provuese dhe se pranimi i tyre nuk dëmton në mënyrë të papërligjur Mbrojtjen.⁶²

42. Mbrojtja kundërshton pranimin si prova jogojore të deklaratave që përmbajnë deklarime publike të bëra nga UÇK-ja dhe Shtabi i Përgjithshëm në veçanti.⁶³

43. Trupi Gjykses është bindur se materialet 008557-008559 dhe SPOE00054898-SPOE00054902-ET, janë të pranueshme. Këto dekrete janë qartësisht relevante për këtë çështje, pasi në to ka prova për veprimet dhe vendimet e Qeverisë së Përkohshme të Kosovës ("QPK") gjatë periudhës kohore përkatëse, dhe, rrjedhimisht, për autoritetin, kompetencat dhe fushat e shtrirjes së tyre. Nga ana tjetër, këto mund të jenë relevante për të përcaktuar kompetencat dhe përgjegjësinë e disa prej të akuzuarve gjatë asaj periudhe si anëtare dhe zyrtarë që

⁶⁰ **W04290**: SPOE00054898-SPOE00054902-ET; *Shih* Shtojcën 4 të Mocionit për Pranimin e Provave Jogojore, materialin 3I; 008557-008559; *Shih* Shtojcën 6 të Mocionit për Pranimin e Provave Jogojore, materialin 652.

⁶¹ **W04290**: 007948-007949-ET; *Shih* Shtojcën 3 të Mocionit për Pranimin e Provave Jogojore, materialin 1T.

⁶² Mocioni për Pranimin e Provave Jogojore, para. 3.

⁶³ Përgjigjja, para. 14; Shtojca 3 e Përgjigjes, f. 23-24; Shtojca 4 e Përgjigjes, f. 92-94; Shtojca 6.11 e Përgjigjes, f. 12-13.

vepronin nën ombrellën e QPK-së dhe për të kuptuar se si QPK-ja ndërvepronte me UÇK-në. Këto materiale janë *prima facie* autentike dhe me vlerë provuese. Ato të gjitha vijnë nga të dhënat e publikuara në RKL. Në dukje, asgjë në to nuk të bën të mendosh se ato nuk janë autentike. Përkundrazi, Trupi Gjykses thekson se ato janë publikuar sipas rendit kronologjik dhe se Dekreti nr. 83/99 është dekret i 28 prillit 1999 i miratuar nga QPK-ja. Ky dokument është nënshkruar nga z. Thaçi, si kryeministër. Paragrafi 3 i këtij dokumenti ka rëndësi të veçantë për çështjen gjyqësore, dhe konkretisht për:

formimin si strukturë e veçantë të Komandës për Doktrinë dhe Stërvitje Ushtarake, e cila do të ketë për detyrë stërvitjen e njësive luftarake. Kjo strukturë do të drejtohet dhe komandohet drejtpërsëdrejti nga Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së.

44. Dokumenti bën pjesë në një grup dokumentesh zyrtare të botuara në një libër. Trupi Gjykses nuk ka marrë ndonjë dokument tjetër zyrtar të vendimeve të dhëna gjatë asaj kohe nga QPK-ja. Dokumenti përmban disa tregues të autenticitetit. Së pari, numërtimi, në përgjithësi, ka përputhshmëri dhe rend kronologjik. Sa mund të konfirmohet zbatimi i masave të parashikuara në këto dokumente, do të verifikohet në gjykim. Së dyti, dokumenti i referohet si bazë ligjore dekretit mbi funksionimin e Qeverisë së Kosovës. Së treti, dokumenti i referohet një urdhri për mobilizim të përgjithshëm. Ky urdhër duket se përfshihet në materialin SPOE00054519-SPOE00054522-ET që mban datën 29 mars 1999. Në dukje, urdhri është lëshuar nga Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së. Koha e lëshimit të urdhrit dhe referenca për dekretin 83/99 përputhen.⁶⁴ Materiali SPOE00054519-SPOE00054522-ET gjithashtu është paraqitur për pranim si provë jोगजore dhe Trupi Gjykses gjykon se ai përmbush kriteret e rregullës 138(1). Ai është relevant, është *prima facie* autentik dhe me vlerë provuese. Për të arritur në këtë përfundim,

⁶⁴ SPOE00054519-SPO0005422-ET (Vendimi nr. 151 i datës 31 mars 1999); *Shih* Shtojcën 4 të Mocionit për Pranimin e Provave Jोगजore, materialin 20.

Trupi Gjykses ka marrë parasysh përmbajtjen e këtyre dokumenteve si dhe faktin se ato konfirmojnë deri diku njëri-tjetrin. Së fundi, nuk ka asgjë që tregon se dokumenti nuk është autentik.

45. Materialet 008557-008559 dhe SPOE00054898-SPOE00054902-ET gjithashtu përmbajnë atë që pretendohet se është Dekreti nr. 84/99, i nënshkruar sërish nga z. Thaçi si kryeministër, në të cilin thuhet:

mbështetur në propozimin e Ministrisë së Mbrojtjes së Kosovës, bazuar në nenin 6, pika "f" të Dekretligjit për Punën e Qeverisë së Përkohshme, Qeveria e Kosovës, në mbledhjen e datës 27 prill 1999, dekretoi:

z. Agim Hasan Çeku emërohet shef i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

46. Trupi Gjykses thekson se ka disa tregues për autenticitetin dhe besueshmërinë e këtij dokumenti. Së pari, nuk ka diskutim se z. Çeku u emërua në fakt në atë post dhe se kjo u bë rreth kohës së përmendur në këtë dokument. Së dyti, numërtimi i këtij dokumenti sërish përkon përgjithësisht me dokumente të ngjashme që pretendohet se janë miratuar nga Qeveria e Përkohshme e Kosovës gjatë asaj periudhe. Ai është hartuar në kuadër të përpjekjes së UÇK-së për t'u transformuar nga një entitet i armatosur kryengritës në një strukturë ushtarake që vepron nën autoritet ekzekutiv.

47. Trupi Gjykses është bindur se po kështu edhe dekretet e tjera të QPK-së të përfshira në këtë dokument, përmbushin kriteret e rregullës 138(1).

48. Trupi Gjykses është gjithashtu bindur se materiali 007948-007949-ET është relevant pasi është një komunikatë nga zona operative e Drenicës sipas së cilës qytetarëve u ndalohet të kërkojnë dokumente udhëtimi nga zyrat serbe, çka nga ana tjetër dëshmon për ushtrimin e komandës dhe kontrollit përkatës brenda UÇK-së. Trupi Gjykses është bindur gjithashtu për autenticitetin dhe vlerën

provuese *prima facie* të këtij materiali, pasi ai ka datë, buron nga arkivat e agjencisë Kosovapress, dhe lidhet me aspektet e evidentuara më lart.

49. Sa i përket cenimit të Mbrojtjes, Trupi Gjykses është bindur se vlera provuese e këtyre materialeve nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të tyre ndaj të akuzuarve. Mbrojtja do të ketë mundësinë të kundërshtojë përmbajtjen e këtyre materialeve përmes marrjes në pyetje të dëshmitarëve përkatës të ZPS-së. Trupi Gjykses nuk ka konstatuar rrethana të tjera që sugjerojnë se me pranimin e këtyre dokumenteve do të shkaktohej ndonjë efekt dëmtues.

50. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses pranon si prova materialet SPOE00054898-SPOE00054902-ET, 008557-008559, SPOE00054519-SPOE00054522-ET dhe 007948-007949-ET.

5. Kategoria 5: Dokumente zyrtare të organizatave

51. ZPS-ja kërkon pranimin si prova jogojore të dy materialeve të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë ("OSBE"),⁶⁵ dy materialeve të Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë ("UNMIK"),⁶⁶ dhe të një materiali të Agjencisë së Kosovës kundër Korrupsionit ("AKK").⁶⁷ ZPS-ja parashtro se këto dokumente janë relevante, autentike dhe me vlerë provuese dhe se pranimi i tyre nuk dëmton në mënyrë të papërligjur Mbrojtjen.⁶⁸

52. Mbrojtja përgjigjet se këto dokumente duhet të paraqiten vetëm përmes autorëve të tyre përkatës.⁶⁹ Mbrojtja parashtro se raportet e Kombeve të Bashkuara ose organizatave joqeveritare në përgjithësi janë konsideruar të

⁶⁵ **W04290:** SITF00012041-00012044; *Shih* Shtojcën 6 të Mocionit për Pranimin e Provave Jogojore, materialin 475; **W04746:** SITF00384552-00384553; *Shih* Shtojcën 6 të Mocionit për Pranimin e Provave Jogojore, materialin 429.

⁶⁶ **W04746:** SPOE00120826-00120838-RED, 068263-068267; *Shih* Shtojcën 6 të Mocionit për Pranimin e Provave Jogojore, materialet 368, 569.

⁶⁷ **W04746:** 076693-076700; *Shih* Shtojcën 6 të Mocionit për Pranimin e Provave Jogojore, materialin 551.

⁶⁸ Mocioni për Pranimin e Provave Jogojore, para. 3.

⁶⁹ Përgjigja, para. 52-55; *Shih gjithashtu* Shtojcën 6.6 të Përgjigjes, f. 14-15, 20-21, 26-27.

papranueshme si prova jогоjore.⁷⁰ Mbrojtja parashtrohet se: (i) ajo ka të drejtë të kundërshtojë provat që përmbajnë këto raporte; (ii) në veçanti, për shkak se jepet pak ose aspak informacion lidhur me mënyrën se si janë siguruar dokumentet, ose për metodologjinë në bazë të së cilës është bërë grumbullimi i fakteve; (iii) në këto raporte shpesh shprehen opinione ose arrihet në përfundime për aspekte që janë kyçe për procesin gjyqësor, të cilat mund të sjellin si rezultat cenimin e funksioneve të Trupit Gjyqësor për gjykimin e fakteve; dhe (iv) kur këto raporte kanë të bëjnë me veprime dhe sjellje të të akuzuarve, ose anëtarëve të rrjetit të tyre të pretenduar, pranimi i tyre cenon në mënyrë të papërligjur të akuzuarit.⁷¹

53. Trupi Gjyqësor gjykon se materialet në vijim janë relevante pasi: (i) materiali SITF00012041-00012044 është raport mbi aktivitetin ditor të Misionit Verifikues të OSBE-së në Kosovë, ku thuhet se W04290 informoi anëtarët e të drejtave të njeriut se 56 persona vijonin të mbaheshin të ndaluar dhe keqtrajtoheshin prej anëtarëve të UÇK-së dhe se ai ia kishte dhënë emrat e këtyre personave "Prishtinës"; (ii) materiali SITF00384552-00384553, është dokument i OSBE-së, ku jepet informacion në lidhje me dy takime me komandantin e zonës së Llapit dhe kreun e policisë ushtarake të asaj zone, në të cilat u diskutuan përpjekjet për të siguruar qasje në objektet e ndalimit; (iii) materiali 068263-068267 është raport i UNMIK-ut, në të cilin jepen detaje të ndalimit të një veture dhe për fotokopjen e një urdhërese, që supozohet se u sekuestrua gjatë ndalimit në fjalë, e që duket se ishte lëshuar nga komandantët e UÇK-së të zonës operative të Llapit, në të cilën bëhej thirrje për "likuidimin" e atyre që pengojnë UÇK-në; dhe (iv) materiali SPOE00120826-00120838-RED është procesverbal zyrtar i seancës gjyqësore në çështjen *Latif Gashi dhe të tjerët*, ku jepen detaje në lidhje me bazat e UÇK-së në Majac, Llapashticë dhe Potok, që janë me rëndësi për të kuptuar organizimin dhe strukturën e UÇK-së, politikën e pretenduar të shënjestrimit të atyre që

⁷⁰ Përgjigja, para. 86-87.

⁷¹ Përgjigja, para. 87-89.

konsideroheshin si kundërshtarë dhe bashkëpunëtorë si dhe krimet e pretenduara në Aktakuzë.⁷²

54. Trupi Gjykses konstaton se ZPS-ja nuk ka vërtetuar relevancën e raportit të AKK-së, ku hidhet dritë mbi pagesat që pretendohet se ka marrë W04746 për punën e tij si këshilltar i Presidencës.⁷³ Ashtu si dhe me njoftimin për shtyp në lidhje me emërimin e W04746-ës të trajtuar më sipër,⁷⁴ ky dokument *mund* të rezultojë i rëndësishëm në të ardhmen dhe të jetë i pranueshëm. Sidoqoftë, në këtë fazë, ZPS-ja nuk ka vërtetuar se për cilin fakt ose cilën rrethanë thelbësore për çështjen do të ishte relevant ky dokument.

55. Trupi Gjykses rikujton qasjen e tij ndaj autenticitetit dhe besueshmërisë së raporteve të organizatave ndërkombëtare, si OSBE-ja dhe UNMIK-u, të përcaktuar në Vendimin mbi Mocionin për Pranimin e Provave Jogojore.⁷⁵ Trupi Gjykses gjykon se këto materiale janë *prima facie* autentike. Dokumentet kanë datë në krye të faqes dhe duket se janë dokumente zyrtare të hartuara në kohën kur kanë ndodhur ngjarjet. Ato i janë dhënë ZPS-së nga OSBE-ja dhe UNMIK-u dhe kanë të gjitha shënimet përcjellëse të dokumenteve të tilla zyrtare. Rrjedhimisht, ato janë *prima facie* autentike.

56. Trupi Gjykses nuk është bindur se ZPS-ja ka vërtetuar vlerën provuese *prima facie* të materialit SITF00012041-00012044. Konkretisht, pa kontekst të mëtijshëm, Trupi Gjykses gjykon se nuk ka prova se si është përgatitur ky raport dhe në çfarë bazohet informacioni i përfshirë në të.

57. Lidhur me vlerën provuese të materialeve SITF00384552-00384553, SPOE00120826-00120838-RED dhe 068263-068267, Trupi Gjykses konstaton se ato kanë vlerë provuese, pasi në to trajtohen politikat ndaj atyre që konsideroheshin

⁷² Aktakuza, para. 15, 19, 35, 37-38, 71, 155, 157.

⁷³ 076693-076700; *Shih* Shtojcën 6 të Mocionit për Pranimin e Provave Jogojore, materialin 551.

⁷⁴ *Shih më lart*, para. 34.

⁷⁵ Vendimi mbi Mocionin për Pranimin e Provave Jogojore, para. 43.

si kundërshtarë të UÇK-së, aspekte në lidhje me ndalimet dhe objektet e ndalimit si dhe krimet e pretenduara në Aktakuzë. Burimi i tyre është i njohur dhe baza e informacionit që ato përmbajnë ka vlerë provuese *prima facie* për faktet që parashtrohen në to. Në të njëjtën kohë, Trupi Gjykses vëren se materiali 068263-068267 përmban informacion të rëndësishëm që mund të jetë inkriminues. Dihet se ku, në çfarë rrethanash dhe kujt iu gjet dokumenti. Megjithatë, ka pak ose aspak informacion se ku e ka marrë këtë dokument personi në fjalë. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses do ta shqyrtojë me kujdes këtë dokument dhe informacionin që ai përmban kur të vendosë për peshën që do t'i japë. Trupi Gjykses gjithashtu thekson se ZPS-ja do të ketë mundësinë t'ia paraqesë këtë dokument disa dëshmitarëve të mundshëm, të cilët mund të jenë në gjendje të komentojnë mbi të dhe besueshmërinë e përmbajtjes së tij.

58. Sa i përket cenimit të Mbrojtjes, Trupi Gjykses është bindur se vlera provuese e materialeve SITF00384552-00384553, SPOE00120826-00120838-RED dhe 068263-068267 nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të tyre ndaj të akuzuarve, pasi Mbrojtja do të mund të kundërshtojë përmbajtjen dhe vlerën provuese të këtyre dokumenteve përmes marrjes në pyetje të dëshmitarëve të palës kundërshtare, përfshirë W04746-ën. Trupi Gjykses nuk ka konstatuar rrethana të tjera që sugjerojnë se me pranimin e këtyre dokumenteve do të shkaktohej ndonjë efekt dëmtues.

59. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses pranon si prova jोगojore materialet SITF00384552-00384553, SPOE00120826-00120838-RED dhe 068263-068267, dhe refuzon pranimin si prova jोगojore të materialeve SITF00012041-00012044 dhe 076693-076700.

6. Kategoria 6: Dokumente që lidhen me UÇK-në

(a) Dokumentet e UÇK-së të nënshkruara nga W04290 dhe W04746.

60. ZPS-ja kërkon pranimin si prova jogojore të 40 materialeve që janë urdhra, kërkesa, programe trajnimi dhe dokumente të tjera të UÇK-së, të nënshkruara nga W04290 ose W04746.⁷⁶ ZPS-ja parashtron se këto dokumente janë relevante, autentike dhe me vlerë provuese dhe se pranimi i tyre nuk dëmton në mënyrë të papërligjur Mbrojtjen.⁷⁷

61. Mbrojtja përgjigjet se dokumentet që janë të lidhura me dëshmitarët e ZPS-së, duhet të paraqiten përmes dëshmitarëve përkatës, në përputhje me parimin e paraqitjes së dëshmime gojore.⁷⁸ Mbrojtja argumenton se Dhomat Gjyqësore të Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë ("TPNJ") kanë konstatuar në mënyrë të përsëritur se paraqitja e dokumenteve përmes dëshmitarit është metodë e preferuar, ndërsa kërkesa për pranimin e provave jogojore është metodë plotësuese e cila duhet të përdoret me masë.⁷⁹ Së fundi, Mbrojtja parashtron se, ndonëse ZPS-ja ishte në dijeni për rëndësinë që kishte dhënia e shpjegimeve se pse këto materiale nuk mund të paraqiteshin përmes dëshmitarit, ajo nuk ka dhënë shpjegime por ka renditur materiale që mund të jenë të rëndësishme, të cilat duket

⁷⁶ **W04290:** U001-7883-U001-7883, U000-8262-U000-8262, U000-8212-U000-8219, U000-8056-U000-8056, U000-8034-U000-8034, U000-8005-U000-8005, U000-7979-U000-7998, U000-7909-U000-7909, U000-7887-U000-7888, U000-7885-U000-7885, U000-7874-U000-7874, U000-7868-U000-7868, U000-7862-U000-7862, U000-7849-U000-7849, U000-7811-U000-7811, U000-7778-U000-7778, U000-7777-U000-7777, U000-7720-U000-7720, U000-7718-U000-7718, U000-7691-U000-7691, U000-7650-U000-7650, U000-2534-U000-2534, U000-1654-U000-1654, U000-1649-U000-1649, U000-1647-U000-1647, U000-1644-U000-1645, U000-1436-U000-1436, SPOE00225798-SPOE00225798, SITF00240682-00240682, IT-05-87 4D00037, IT-04-84 P00231, IT-03-66 P93, 097047-097056, 096746-096747 dhe 096318-096335; *Shih* Shtojcën 6 të Mocionit për Pranimin e Provave Jogojore, materialet 68, 116, 118, 120, 122, 124, 126, 128, 130, 132, 134, 136, 138, 140, 142, 146, 148, 152, 154, 156, 158, 174, 178, 180, 182, 184-185, 270, 460, 499, 501, 503, 533, 535, 537; **W04746:** U001-0291-U001-0292, U000-2142-U000-2142-ET, SITF00242138-SITF00242141, SITF00069016-SITF00069016 dhe 099824-099827; *Shih* Shtojcën 6 të Mocionit për Pranimin e Provave Jogojore, materialet 104, 106, 458, 472 dhe 526.

⁷⁷ Mocioni për Pranimin e Provave Jogojore, para. 3.

⁷⁸ Përgjigja, para. 52.

⁷⁹ Përgjigja, para. 53.

se lidhen drejtpërdrejt me dëshmitarët dhe, për rrjedhojë, këto materiale nuk duhet të pranohen.⁸⁰

62. Fillimisht, Trupi Gjykses rikujton konstatimin e tij lidhur me kohën e lëshimit të Vendimit mbi Mocionin për Pranimin e Provave Jogojore dhe se Trupi Gjykses mund të marrë vendim në lidhje me pranueshmërinë e provave ose *para gjykimit ose gjatë tij*,⁸¹ që vlen njëllor edhe për këtë vendim.

63. Trupi Gjykses vlerëson se në këto dokumente përfshihen urdhra, kërkesa, plane trajnimi, memorandume të brendshme, broshura që përmbajnë rregullore disiplinore të UÇK-së dhe rregulla të sjelljes, si dhe një vendim “amnistie” të UÇK-së, e dokumente të tjera të nënshkruara nga W04290 ose W04736, të cilat lidhen me akuzat e paraqitura në Aktakuzë, që, ndër të tjera, kanë të bëjnë me: (i) organizimin dhe hierarkinë komanduese të UÇK-së; (ii) strukturën dhe organizimin e zonës operative të Drenicës; dhe (iii) krimet që pretendohet se janë kryer në Likoc.⁸²

64. Në lidhje me autenticitetin, Trupi Gjykses vlerëson se dokumentet janë *prima facie* autentike pasi kanë datë, janë të nënshkruara nga W04290, si komandant i zonës operative të Drenicës, ose nga W04746 si komandant i zonës operative të Llapit,⁸³ apo nga anëtarë të tjerë të personelit ushtarak përkatës, dhe shumë prej materialeve kanë simbolin e UÇK-së në krye të tyre.⁸⁴ Trupi Gjykses thekson se materiali U000-7868-U000-7868 nuk ka datë por konstaton se kjo nuk cenon autenticitetin e tij pasi kërkesa ka numër, ka emërtimin zyrtar në krye të saj dhe

⁸⁰ Përgjigjja, para. 54; *Shih gjithashtu* Shtojcën 1 të Përgjigjes, f. 51-52; Shtojcën 6.2.1 të Përgjigjes, f. 3-34, 36-42; Shtojcën 6.2.4 të Përgjigjes, f. 56, 18-20; Shtojcën 6.5 të Përgjigjes, f. 13-14

⁸¹ Vendimi mbi Mocionin për Pranimin e Provave Jogojore, para. 18-19.

⁸² Aktakuza, para. 32-57, 62, 99, 139-141.

⁸³ U001-0291-U001-0292, U000-0289-U0010290, U000-2142-U000-2142-ET, SITF00242138-SITF00242141, SITF00069016-SITF00069016 dhe 099824-099827; *Shih* Shtojcën 6 të Mocionit për Pranimin e Provave Jogojore, materialet 104, 106, 107, 458, 472, 526.

⁸⁴ *Shih për shembull*, Shtojcën 6 të Mocionit për Pranimin e Provave Jogojore, materialet 140, 146, 270, 460, 499, 501, 537, 539, 541.

është e nënshkruar nga W04290.⁸⁵ Trupi Gjykses gjithashtu thekson se edhe materiali SITF00240682-00240682 nuk ka datë. Megjithatë, ZPS-ja mbështetet në këtë material për të treguar shkallën e organizimit dhe strukturën brenda UÇK-së, e jo për të përcaktuar se në cilën datë konkrete ka ndodhur ngjarja,⁸⁶ dhe duke qenë se treguesit e tjerë të autenticitetit janë të pranishëm, materiali është *prima facie* autentik.

65. Sidoqoftë, Trupi Gjykses vlerëson se materialet U000-8262-U000-8262, U000-2534-U000-2534, U000-1647-U000-1647, U000-1644-U000-1645, IT-03-66 P93, 097047-097056 dhe 096746-096747 kërkojnë kontekst të mëtejshëm për të verifikuar përmbushjen e kriterëve të pranueshmërisë të këtyre provave materiale të propozuara. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses nuk do të pranojë si prova jogojore materialet U000-8262-U000-8262, U000-2534-U000-2534, U000-1647-U000-1647, U000-1644-U000-1645, IT-03-66 P93, 097047-097056 dhe 096746-096747 në këtë fazë.

66. Trupi Gjykses vlerëson se ZPS-ja ka vërtetuar vlerën provuese *prima facie* të materialeve të mbetura, konkretisht të materialeve U001-7883-U001-7883, U000-8212-U000-8219, U000-8056-U000-8056, U000-8034-U000-8034, U000-8005-U000-8005, U000-7979-U000-7998, U000-7909-U000-7909, U000-7887-U000-7888, U000-7885-U000-7885, U000-7874-U000-7874, U000-7868-U000-7868, U000-7862-U000-7862, U000-7849-U000-7849, U000-7811-U000-7811, U000-7778-U000-7778, U000-7777-U000-7777, U000-7720-U000-7720, U000-7718-U000-7718, U000-7691-U000-7691, U000-7650-U000-7650, U000-1654-U000-1654, U000-1649-U000-1649, U000-1436-U000-1436, SPOE00225798-SPOE00225798, SITF00240682-00240682, IT-05-87 4D00037, IT-04-84 P00231, 096318-096335, U001-0291-U001-0292, U000-2142-U000-2142-ET, SITF00242138-SITF00242141, SITF00069016-SITF00069016 dhe 099824-099827. Ato kanë të bëjnë me rolin dhe përgjegjësitë e W04290-s si komandant i

⁸⁵ *Shih* Shtojcën 6 të Mocionit për Pranimin e Provave Jogojore, materialin 136.

⁸⁶ *Shih* Shtojcën 6 të Mocionit për Pranimin e Provave Jogojore, materialin 460.

zonës operative të Drenicës dhe me rolin dhe përgjegjësitë e W0476-ës të zonës operative të Llapit. Në shikim të parë, të gjitha këto dokumente duket se janë urdhra dhe kërkesa të nënshkruara nga W04290 dhe W04746.

67. Sa i përket cenimit të Mbrojtjes, Trupi Gjykses është bindur se vlera provuese e këtyre dokumenteve nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të tyre ndaj të akuzuarve. Mbrojtja do të mund të kundërshtojë përmbajtjen e këtyre materialeve përmes marrjes në pyetje të dëshmitarëve të palës kundërshtare, përfshirë W04290-n dhe W04746-ën, që janë personat që pretendohet se kanë nënshkruar dokumentet përkatëse.

68. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses pranon si prova jogojore materialet U001-7883-U001-7883, U000-8212-U000-8219, U000-8056-U000-8056, U000-8034-U000-8034, U000-8005-U000-8005, U000-7979-U000-7998, U000-7909-U000-7909, U000-7887-U000-7888, U000-7885-U000-7885, U000-7874-U000-7874, U000-7868-U000-7868, U000-7862-U000-7862, U000-7849-U000-7849, U000-7811-U000-7811, U000-7778-U000-7778, U000-7777-U000-7777, U000-7720-U000-7720, U000-7718-U000-7718, U000-7691-U000-7691, U000-7650-U000-7650, U000-1654-U000-1654, U000-1649-U000-1649, U000-1436-U000-1436, SPOE00225798-SPOE00225798, SITF00240682-00240682, IT-05-87 4D00037, IT-04-84 P00231, 096318-096335, U001-0291-U001-0292, U000-2142-U000-2142-ET, SITF00242138-SITF00242141,⁸⁷ SITF00069016-SITF00069016 dhe 099824-099827 dhe refuzon pranimin si prova jogojore të materialeve U000-8262-U000-8262, U000-2534-U000-2534, U000-1647-U000-1647, U000-1644-U000-1645, IT-03-66 P93, 097047-097056 dhe 096746-096747.

⁸⁷ Krahas paraqitjes së materialit nga autori i pretenduar i tij, W04746, ky material u dorëzua për t'u përdorur edhe në lidhje me dëshminë e W04323-shit. Duke qenë se W04746 është planifikuar të dëshmojë përpara W04323-shit, të akuzuarve nuk do t'u mohohet mundësia për të marrë në pyetje autorin e tij, para se materiali të mund të diskutohet gjatë dhënies së dëshmisë nga W04323.

(b) Komunikatat e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së

69. ZPS-ja kërkon pranimin si prova jोगojore të 10 materialeve që janë komunikata e që pretendohet të jenë lëshuar nga Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së, dhe të përgjigjeve ndaj këtyre komunikatave, të cilat ajo ka evidentuar se lidhen me W04290-n.⁸⁸ ZPS-ja parashtro se këto dokumente janë relevante, autentike dhe me vlerë provuese dhe se pranimi i tyre nuk dëmton në mënyrë të papërligjur Mbrojtjen.⁸⁹

70. Mbrojtja kundërshton pranimin si prova jोगojore të këtyre komunikatave. Konkretisht, Mbrojtja argumenton se shumë nga po këto komunikata janë paraqitur përmes dëshmitarëve në TPNJ, ku Dhomat Gjyqësore konstatuan se: (i) këto dokumente ishin shkruar nga persona të ndryshëm, ndër të cilët komandantë të zonave, pa dijeninë e Shtabit të Përgjithshëm; (ii) ato ishin përdorur si mjete propagande; dhe (iii) në kuadër të kësaj fushate, përmbajtja e tyre shpesh ishte ekzagjeruar ose ndryshuar.⁹⁰ Mbrojtja argumenton se këto konstatime të Dhomave Gjyqësore të TPNJ-së hedhin dyshime të konsiderueshme mbi besueshmërinë dhe vërtetësinë e këtyre dokumenteve, të cilat, në pamje të parë, nuk përmbushin standardin e rregullës 138.⁹¹ Gjithashtu, Mbrojtja parashtro se, duke qenë se disa prej tyre janë të panënshkruara, të pavulosura dhe nuk kanë date, nuk u dihet autorësia, është e paqartë se mbi bazën e çfarë informacionesh janë përpiluar dhe versionet “origjinale” të tyre nuk disponohen, këto dokumente, pa u dhënë kontekst nga dëshmitari, nuk përmbushin kriteret për t’u pranuar si prova.⁹²

⁸⁸ **W04290**: U016-2743-U016-2743-EDT, U016-2735-U016-2735 ET Rishikuar, IT-04-84 P00966.E, U008-1614-U008-1614-AT, 086833-086833-ET, 043802-043802, 043800-043800, 043805-043805, 043861-043861 dhe 051864-051865; *Shih* Shtojcën 1 të Mocionit për Pranimin e Provave Jोगojore, materialet 1W, 1X, 1G2, 2J, 2M, 36, 38, 40, 43-44.

⁸⁹ Mocioni për Pranimin e Provave Jोगojore, para. 3.

⁹⁰ Përgjigjja, para. 16.

⁹¹ Përgjigjja, para. 17.

⁹² Përgjigjja, para. 17; *Shih gjithashtu* Shtojcën 1 të Përgjigjes, f. 31-33, 46-48, 62-63, 66-67, 139-144, 149-152.

71. Në kuadër të marrjes së vendimit në lidhje me pranimin e tyre, nuk është nevoja që Trupi Gjykses të dalë me një konstatim të prerë për përkatësinë apo autorësinë. Trupi Gjykses duhet të vendosë vetëm nëse janë përmbushur ose jo kriteret e rregullës 138(1) në lidhje me këto dokumente.

72. Trupi Gjykses vlerëson se dokumentet e renditura nën këtë titull përfshijnë komunikata të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së që lidhen me deklarata publike të bëra nga UÇK-ja dhe konstaton se ato janë relevante, ndër të tjera, për ekzistencën e konfliktit të armatosur, pretendimet për vënien në shënjestër dhe legjitimimin e sulmeve ndaj atyre që pretendohet se ishin bashkëpunëtorë ose kundërshtarë, dhe për krimet që pretendohet se janë kryer në Qirez dhe Baicë.⁹³

73. Në lidhje me autenticitetin, Trupi Gjykses është bindur për autenticitetin *prima facie* të këtyre dokumenteve. Komunikatat fillimisht janë publikuar në gazetën “Zëri i Kosovës”, “Koha Ditore” dhe/ose “Bota e Re”. Disa prej tyre janë publikuar në më shumë se një prej këtyre mediave.⁹⁴ ZPS-ja ka dhënë datat e publikimit të tyre dhe komunikatat kanë numra, gjë që i mundëson Mbrojtjes t’u japë kontekst të mëtjshëm. Trupi Gjykses ende nuk ka marrë prova që nga Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së në atë kohë të jetë mohuar lëshimi i komunikatave apo që nga ndonjë prej anëtarëve të tij të jetë kontestuar origjina ose autorësia e këtyre dokumenteve. Mbrojtja vë në dukje se disa prej tyre janë të panënshkruara, të pavulosura dhe nuk kanë datë. Trupi Gjykses thekson se komunikatat e trajtuara në këtë vendim kanë data. Gjithashtu, Trupi Gjykses thekson se, në përgjithësi, komunikatat e UÇK-së ishin të panënshkruara dhe të pavulosura. Trupi Gjykses, në vlerësimin përfundimtar të tij për vërtetësinë dhe vlerën provuese të komunikatave, do të marrë parasysh mungesën e nënshkrimit.

⁹³ Aktakuza, para. 17-20, 76, 110-111.

⁹⁴ *Shih për shembull*, Shtojcën 6 të Mocionit për Pranimin e Provave Jogojore, materialet 2M, 35-36, 37A, 39A, 40 ku: (i) materialet 2M dhe 37A; (ii) materialet 35 dhe 36; dhe (iii) materialet 39A dhe 40, konfirmojnë në mënyrë të ndërsjellë njëri-tjetrin.

74. Për dy dokumente nevojitet të bëhen komente shtesë. Në dokumentet 043800-043800 dhe 051864-051865, anëtarë të UÇK-së, të cilët janë të panjohur, ose që ende nuk janë thirrur si dëshmitarë, shprehin mospajtimin e tyre me komunikatat. Gjithashtu, nga këto dy dokumente, është e paqartë se në çfarë mbështetet informacioni që përmbajnë ato. Duke qenë se këto dokumente po paraqiten për të vërtetuar se disa anëtarë të UÇK-së vunë në dyshim dhe kontestuan vërtetësinë e përmbajtjes së komunikatave të lëshuara nga Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së, Trupi Gjykses është i gatshëm t'i pranojë ato vetëm për këtë qëllim. Në këtë kontekst, Trupi Gjykses thekson se këto materiale, në të cilat u kthehet përgjigje komunikatave, bëjnë njëfarë konfirmimi të autenticitetit të komunikatave. Ato gjithashtu ofrojnë prova të cilat mund të jenë relevante për vlerësimin e përmbajtjes dhe qëllimit ose qëllimeve të komunikatave të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses gjykon se materialet 043800-043800 dhe 051864-051865 kanë vlerë provuese *prima facie* vetëm për të vërtetuar se disa anëtarë të UÇK-së vunë në dyshim dhe kontestuan vërtetësinë e përmbajtjes së komunikatave të lëshuara, të hartuara nga Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së.

75. Trupi Gjykses është gjithashtu bindur se materialet U016-2743-U016-2743-EDT, U016-2735-U016-2735 ET Rishikuar, IT-04-84 P00966.E, U008-1614-U008-1614-AT, 086833-086833-ET, 043802-043802, 043805-043805 dhe 043861-043861 kanë vlerë provuese *prima facie*, si dhe besueshmëri, pasi ato janë komunikata të publikuara në emër të UÇK-së dhe të cilat mund të jenë relevante për vërtetimin e fakteve dhe rrethanave të vëna në dukje më lart në lidhje me këtë çështje.⁹⁵ Fakti që një prej qëllimeve të komunikatave ishte i natyrës propagandistike, nuk i bën të papranueshme ato. Trupi Gjykses do të përcaktojë, në bazë të të gjitha provave, se cilit qëllim ose cilave qëllime synonin t'i shërbenin këto materiale. Edhe sugjerimi i Mbrojtjes se përmbajtja e disa ose të gjitha këtyre komunikatave mund

⁹⁵ *Shih më lart*, paragrafin 72.

të jetë ekzagjeruar, nuk përbën arsye për mospranimin e tyre si prova jोगojore. Aty ku vërtetohet, kjo do të kërkonte që Trupi Gjykues të bëjë vlerësimin e përmbajtjes së tyre dhe pretendimeve të përfshira në to me shkallën e nevojshme të kujdesit.

76. Sa i përket cenimit të Mbrojtjes, Trupi Gjykues është bindur se vlera provuese e këtyre dokumenteve nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të tyre ndaj të akuzuarve. Mbrojtja do të ketë mundësi të kundërshtojë përmbajtjen e këtyre materialeve përmes marrjes në pyetje të dëshmitarëve përkatës.

77. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykues pranon si prova materialet U016-2743-U016-2743-EDT, U016-2735-U016-2735-ET Rishikuar, IT-04-84 P00966.E, U008-1614-U008-1614-AT, 086833-086833-ET, 043802-043802, 043805-043805 dhe 043861-043861. Trupi Gjykues gjithashtu pranon si prova materialet 043800-043800 dhe 051864-051865 por do t'i përdorë ato vetëm për të vërtetuar se disa anëtarë të UÇK-së vunë në dyshim dhe kontestuan vërtetësinë e përmbajtjes së komunikatave të lëshuara nga Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së.

(c) Rregulloret, programet dhe dokumentet e trajnimit të UÇK-së

78. ZPS-ja kërkon pranimin si prova të pesë materialeve që janë rregullore, programe dhe dokumente trajnimi të UÇK-së.⁹⁶ ZPS-ja parashtrohet se këto dokumente janë relevante, autentike dhe me vlerë provuese dhe se pranimi i tyre nuk dëmton në mënyrë të papërligjur Mbrojtjen.⁹⁷

79. Mbrojtja përgjigjet se udhëzuesit, rregullat dhe rregulloret nuk duhet të pranohen si prova jोगojore, pa pasur informacion se ku, kur dhe si janë nxjerrë

⁹⁶ **W04290**: U000-9272-U000-9286 dhe IT-05-87.1 P00436 (që lidhet edhe me W04746); *Shih* Shtojcën 6 të Mocionit për Pranimin e Provave Jोगojore, materialet 112, 493; **W04746**: U002-2800-U002-2822, U000-9858-U000-9888 dhe U000-9349-U000-9364; *Shih* Shtojcën 6 të Mocionit për Pranimin e Provave Jोगojore, materialet 60, 108, 110.

⁹⁷ Mocioni për Pranimin e Provave Jोगojore, para. 3.

dhe për kë zbatohen.⁹⁸ Mbrojtja parashtrohet se këto materiale nuk kanë pothuajse asnjë tregues të autenticitetit, pasi ato shpesh nuk përmbajnë asnjë të dhënë mbi autorësinë, përveç stemës së UÇK-së, datës së dokumentit dhe mënyrës në të cilën janë marrë, përtej formulimeve të përgjithshme, si p.sh. se janë dhënë nga TPNJ-ja ose janë sekuestruar prej të akuzuarve, dhe se ZPS-ja nuk ka arritur të vërë në dukje mjaftueshëm relevancën e secilit material.⁹⁹ Së fundi, Mbrojtja argumenton se, meqenëse ZPS-ja synon t'i paraqesë këto materiale për të provuar elementët kyçë të provave dhe argumenteve të saj, konkretisht nivelin e organizimit të UÇK-së dhe autoritetin e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, pranimi i tyre si prova jogjore do të cenonte të akuzuarit, të cilët nuk do të mund të kundërshtonin pranueshmërinë e këtyre materialeve përmes dëshmitarit. Mbrojtja argumenton se ky cenim bëhet edhe më i madh nëse ZPS-ja synon të thërrasë dëshmitarë që mbanin pozita udhëheqëse brenda UÇK-së.¹⁰⁰

80. Në lidhje me parashtrimet e Mbrojtjes së këto dokumente janë shumë të rëndësishme për t'u pranuar si prova jogjore, Trupi Gjyqësor vë në dukje se, ndonëse këto rregulla dhe rregullore mund të tregojnë se ato u miratuan si dhe një shkallë të caktuar organizimi të UÇK-së, në fund Trupi Gjyqësor do t'i bazojë konstatimet e tij në lidhje me to në tërësinë e provave përkatëse. Në veçanti, Trupi Gjyqësor do të marrë parasysh jo vetëm ekzistencën e këtyre rregullave dhe rregulloreve, por edhe shkallën e zbatimit konkret të tyre.

81. Trupi Gjyqësor vlerëson se në përmbajtjen e këtyre dokumenteve përfshihen programe, dokumente trajnimi, rregullore dhe praktika që kanë të bëjnë me përgjegjësitë e UÇK-së. Këto janë të rëndësishme për një numër aspektesh të kësaj çështjeje, ndër të cilat: (i) autoriteti i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK për të miratuar këto rregullore, dhe aspektet në lidhje me kompetencat dhe përgjegjësitë

⁹⁸ Përgjigjja, para. 102.

⁹⁹ Përgjigjja, para. 103; *Shih* Shtojcën 6.2.4 të Përgjigjes, f. 1-3; Shtojcën 6.5 të Përgjigjes, f. 6-9, 14-15.

¹⁰⁰ Përgjigjja, para. 105.

e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së dhe anëtarëve të tij; (ii) niveli i koordinimit dhe organizimit të UÇK-së; dhe (iii) hierarkia brenda UÇK-së dhe autoriteti i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, veçanërisht sa u takon çështjeve disiplinore.¹⁰¹

82. Në lidhje me autenticitetin e dokumenteve, Trupi Gjykses vlerëson se dokumentet janë *prima facie* autentike. Në pamje të parë, të gjitha këto dokumente përmbajnë tregues që të lënë të kuptosh se ato vijnë nga UÇK-ja. Të gjitha mbajnë datën "1998", tri prej dokumenteve kanë stemën e UÇK-së¹⁰² dhe dy dokumente të tjera kanë titullin UÇK të shtypur me makinë shkrimi.¹⁰³ Këta tregues të lënë të kuptosh se dokumentet janë miratuar nga UÇK-ja. Trupi Gjykses thekson se disa prej këtyre dokumenteve përmenden në dokumente të tjera të UÇK-së. Për pranimin e tyre, nuk është e nevojshme që Trupi Gjykses të përcaktojë identitetin e personit i cili i ka shkruar këto dokumente në emër të UÇK-së. Dhe, nëse do të jetë e rëndësishme për konstatimet e Trupit Gjykses, kjo do të përcaktohet në përfundim të gjykit të çështjes në bazë të të gjitha provave përkatëse që janë administruar.

83. Gjithashtu, të gjitha këto dokumente kanë vlerë provuese *prima facie*. Ato, për arsyet e parashtruara në paragrafin pararendës, kanë tregues të mjaftueshëm të besueshmërisë dhe përmbajnë provat përkatëse të fakteve dhe rrethanave, veçanërisht sa u takon aspekteve të autoritetit dhe kompetencave në çështjet disiplinore.¹⁰⁴

84. Sa i përket cenimit të Mbrojtjes, Trupi Gjykses është bindur se vlera provuese e këtyre dokumenteve nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të tyre ndaj të akuzuarve. Mbrojtja do të ketë mundësinë të paraqesë provat dhe argumentet e saj në lidhje

¹⁰¹ Aktakuza, para. 15, 19, 37, 39.

¹⁰² U002-2800-U002-2822, U000-9349-U000-9364 dhe IT-05-87.1 P00436; Shih Shtojcën 6 të Mocionit për Pranimin e Provave Jogojore, materialet 60, 110, 493.

¹⁰³ U000-9858-U000-9888 dhe U000-9272-U000-9286; Shtojca 6 e Mocionit për Pranimin e Provave Jogojore, materialet 108, 112.

¹⁰⁴ Shih më lart, paragrafin 81.

me këto materiale përmes marrjes në pyetje të dëshmitarëve përkatës të ZPS-së. Siç u përmend më lart, rëndësia themelore që pretendohet se kanë këto dokumente për provat dhe argumentet e ZPS-së nuk shkakton efekt dëmtues në kuptim të rregullës 138(1). “Efekti dëmtues” në këtë kontekst nuk i referohet rëndësisë/vlerës provuese të një materiali të propozuar, por padrejtësisë që do të shkaktohej nga pranimi i dokumentit. Trupi Gjykues vlerëson se rëndësia kyçe që mund të ketë një dokument, nuk e pengon pranimin e tij si provë jogojore, pasi rëndësia kyçe dhe atribuimi i tyre i mundshëm të akuzuarve, është diçka që do të përcaktohet në gjykim.

85. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykues pranon si prova jogojore materialet U000-9272-U000-9286, IT-05-87.1 P00436, U002-2800-U002-2822, U000-9858-U000-9888 dhe U000-9349-U000-9364.

(d) Dokumentet e shkruara me dorë

86. ZPS-ja kërkon pranimin e shtatë dokumenteve të shkruara me dorë.¹⁰⁵ Ajo parashtrohet se këto dokumente janë relevante, autentike dhe me vlerë provuese dhe se pranimi i tyre nuk dëmton në mënyrë të papërligjur Mbrojtjen.¹⁰⁶

87. Mbrojtja përgjigjet se këto dokumente duhet të paraqiten vetëm përmes autorëve të tyre përkatës,¹⁰⁷ se nuk dihet burimi origjinal i dokumenteve, se ato nuk janë autentike, nuk lidhen mjaftueshëm me veprat penale ose format e

¹⁰⁵ **W04290:** U002-3436-U002-3441, U002-2855-U002-2868, U000-8363-U000-8363, U000-2419-U000-2420 dhe 098615-098626 (që lidhet edhe me W04746); *Shih* Shtojcën 6 të Mocionit për Pranimin e Provave Jogojore, materialet 54, 58, 114, 176, 531. **W01236:** U001-5195-U001-5244; *Shih* Shtojcën 6 të Mocionit për Pranimin e Provave Jogojore, materialin 78; **W04746:** U001-2310-U001-2319; *Shih* Shtojcën 6 të Mocionit për Pranimin e Provave Jogojore, materialin 82.

¹⁰⁶ Mocioni për Pranimin e Provave Jogojore, para. 3.

¹⁰⁷ Përgjigjja, para. 52-55.

përgjegjësisë penale të paraqitura në Aktakuzë, dhe se efekti dëmtues i tyre zhbën në një masë të konsiderueshme vlerën provuese të tyre.¹⁰⁸

88. Trupi Gjykues thekson se dokumentet e renditura nën këtë titull përfshijnë: (i) fatura të shkruara me dorë për shpenzime logjistike në emër të zonës operative të Drenicës;¹⁰⁹ (ii) shënime të shkruara me dorë, që përmbajnë shkurtesa të karakterit ushtarak, një fragment nga një intervistë dhe procesverbalin e një seance të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së;¹¹⁰ (iii) dokumente të shkruara me dorë që janë raporte ditore dhe mbajnë datat 18 maj dhe 1 qershor 1998, në të cilat përfshihen informacione për bashkëpunëtorët e dyshuar;¹¹¹ (iv) një urdhër të shkruar me dorë, pretendohet në emër të W04290-s, për trajnimin e komandantëve;¹¹² (v) shënime të shkruara me dorë në lidhje me leksionet mbi temat ushtarake;¹¹³ dhe (vi) një fletore me shënime të shkruara me dorë për ambulancën e UÇK-së.¹¹⁴

89. Trupi Gjykues konstaton se këto materiale janë relevante, ndër të tjera për të kuptuar: (i) funksionimin e përgjithshëm të UÇK-së dhe nivelin e organizimit; (ii) kompetencat dhe përgjegjësitë e atyre që përmenden në këto dokumente; (iii) politikën që pretendohet se ndiqej ndaj bashkëpunëtorëve dhe zbatimin e saj; (iv) funksionimin dhe përgjegjësitë e Shtabit të Përgjithshëm; dhe (v) shkallën e sofistikimit dhe organizimit operativ të UÇK-së.¹¹⁵

90. Trupi Gjykues thekson se një dokument i shkruar me dorë nuk është si i tillë i papranueshëm. Megjithatë, ashtu si çdo dokument tjetër, ai duhet të demonstrojë

¹⁰⁸ Përgjigjja, para. 97-101; *Shih gjithashtu* Shtojcën 6.1 të Përgjigjes, f. 3-5, 10-11, 47-48; Shtojcën 6.2.1 të Përgjigjes, f. 2-5, 39-40.

¹⁰⁹ U002-3436-U002-3441; *Shih* Shtojcën 6 të Mocionit për Pranimin e Provave Jogojore, materialin 54.

¹¹⁰ U002-2855-U002-2868; *Shih* Shtojcën 6 të Mocionit për Pranimin e Provave Jogojore, materialin 58.

¹¹¹ U000-8363-U000-8363 dhe 098615-098626; *Shih* Shtojcën 6 të Mocionit për Pranimin e Provave Jogojore, materialet 114, 531.

¹¹² U000-2419-U000-2420; *Shih* Shtojcën 6 të Mocionit për Pranimin e Provave Jogojore, materialin 176.

¹¹³ U001-2310-U001-2319; *Shih* Shtojcën 6 të Mocionit për Pranimin e Provave Jogojore, materialin 82.

¹¹⁴ U001-5195-U001-5244; *Shih* Shtojcën 6 të Mocionit për Pranimin e Provave Jogojore, materialin 78.

¹¹⁵ Aktakuza, para. 15, 19, 37, 39.

tregues të mjaftueshëm të autenticitetit dhe vlerës provuese *prima facie*, si dhe të besueshmërisë. Trupi Gjykues vlerëson se materialet U002-3436-U002-3441, U002-2855-U002-2868, U000-8363-U000-8363, U000-2419-U000-2420, 098615-098626, U001-2310-U001-2319 dhe U001-51950-U001-5244, pa u dhënë kontekst të mëtejshëm nga dëshmitari, nuk janë mjaftueshëm autentike dhe të besueshme, pasi disa prej tyre nuk kanë datë, dhe për disa është e paqartë se kush është autor i materialeve dhe në çfarë informacioni bazohen. Rrjedhimisht, Trupi Gjykues nuk do t'i pranojë këto materiale si prova jogojore.

91. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykues refuzon pranimin si prova jogojore të materialeve U002-3436-U002-3441, U002-2855-U002-2868, U000-8363-U000-8363, U000-2419-U000-2420, 098615-098626, U001-2310-U001-2319 dhe U001-5195-U001-5244.

(e) Dokumente të tjera të UÇK-së

92. ZPS-ja kërkon pranimin shtatë materialeve të tjera, për të cilat gjithashtu pretendon se vijnë nga UÇK-ja.¹¹⁶ ZPS-ja parashtroi se këto dokumente janë relevante, autentike dhe me vlerë provuese dhe se pranimi i tyre nuk dëmton në mënyrë të papërligjur Mbrojtjen.¹¹⁷

93. Mbrojtja përgjigjet se këto dokumente duhet të paraqiten vetëm përmes autorëve të tyre përkatës, se nuk dihet burimi origjinal i dokumenteve, se ato nuk janë autentike, nuk lidhen mjaftueshëm me veprat penale ose format e

¹¹⁶ **W04290**: U017-3349-U017-3363, U003-4775-U003-4784; *Shih* Shtojcën 6 të Mocionit për Pranimin e Provave Jogojore, materialet 3, 46; **W04746**: U001-0504-U001-0504-RED, U001-0399-U001-0400, SPOE00119160-SPOE00119160, SITF0024242577-SITF00242577 dhe 056474-056474; *Shih* Shtojcën 6 të Mocionit për Pranimin e Provave Jogojore, materialet 100, 102, 371, 456, 616.

¹¹⁷ Mocioni për Pranimin e Provave Jogojore, para. 3.

përgjegjësisë penale të paraqitura në Aktakuzë, dhe se efekti dëmtues i tyre zhbën në një masë të konsiderueshme vlerën provuese të tyre.¹¹⁸

94. Ndonëse materiali U003-4775-U003-4784 disponohet vetëm pjesërisht në gjuhën angleze, kjo nuk e ka penguar Trupin Gjykses që të bëjë vlerësimin e këtij materiali, megjithatë, Trupi Gjykses konstaton se ZPS-ja nuk ka vërtetuar relevancën e materialit U003-4775-U003-4784. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses refuzon pranimin si provë jogjore të materialit U003-4775-U003-4784.

95. Trupi Gjykses vlerëson se dokumentet e mbetura të renditura nën këtë titull përfshijnë: (i) të dhënat e kandidatëve të propozuar të policisë ushtarake për Brigadën 112 në zonën operative të Drenicës;¹¹⁹ (ii) një urdhër për lirimin nga ndalimi të një personi,¹²⁰ (iii) një urdhër për ndalimin e serbëve të veshur me uniforma policie;¹²¹ (iv) një vendim për përfundimin e ndalimit të një personi;¹²² (v) një urdhër luftimi;¹²³ dhe (vi) formularë për fletëthirrje të policisë ushtarake të UÇK-së.¹²⁴ Trupi Gjykses konstaton se secili dhe të gjitha këto materiale, janë relevante. Ndër të tjera, ato kanë të bëjnë me: (i) funksionimin, strukturën, përgjegjësitë dhe operacionet e UÇK-së; (ii) rolin, funksionimin dhe përgjegjësitë e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së; (iii) kompetencat dhe autoritetin brenda UÇK-së për të kryer ndalime; dhe (iv) krimet që pretendohet se janë kryer në rajonet e Bares dhe Bajgorës gjatë periudhës që përfshin Aktakuza.¹²⁵

¹¹⁸ Përgjigjja, para. 52-55; *Shih gjithashtu* Shtojcën 6.2.1 të Përgjigjes, f. 1-2; Shtojcën 6.2.4 të Përgjigjes, f. 3-4, 20.

¹¹⁹ U017-3349-U017-3363; *Shih* Shtojcën 6 të Mocionit për Pranimin e Provave Jogjore, materialin 3.

¹²⁰ U001-0504-U001-0504-RED; *Shih* Shtojcën 6 të Mocionit për Pranimin e Provave Jogjore, materialin 100.

¹²¹ SPOE00119160-SPOE00119160; *Shih* Shtojcën 6 të Mocionit për Pranimin e Provave Jogjore, materialin 371.

¹²² SITF00242577-00242577; *Shih* Shtojcën 6 të Mocionit për Pranimin e Provave Jogjore, materialin 456.

¹²³ U001-0399-U001-0400; *Shih* Shtojcën 6 të Mocionit për Pranimin e Provave Jogjore, materialin 102.

¹²⁴ 056474-056474. *Shih* Shtojcën 6 të Mocionit për Pranimin e Provave Jogjore, materialin 616.

¹²⁵ Aktakuza, para. 37, 39, 70, 106, 156.

96. Trupi Gjykues është bindur se dokumentet janë *prima facie* autentike, pasi ato përmbajnë tregues të autenticitet, ndër të cilët emërtimi zyrtar në krye të dokumenteve, numri i referencës, data, vula dhe/ose nënshkrimet.

97. Sidoqoftë, Trupi Gjykues vlerëson se ZPS-ja nuk ka vërtetuar vlerën provuese *prima facie* të materialit U017-3349-U017-3363. Natyra e këtij materiali bën të qartë se nevojitet kontekst i mëtejshëm përpara se dokumenti të mund të pranohet si provë. Rrjedhimisht, Trupi Gjykues nuk do ta pranojë si provë këtë material në këtë fazë të procesit.

98. Trupi Gjykues vlerëson se është vërtetuar se materialet U001-0504-U001-0504-RED, SPOE00119160-SPOE00119160, SITF0024242577-SITF00242577, U001-0399-U001-0400 dhe 056474-056474, kanë vlerë provuese *prima facie*, pasi ato ofrojnë informacion të mëtejshëm që provon, ndër të tjera, funksionimin e UÇK-së, hierarkinë komanduese lidhur me veprimtaritë operative të UÇK-së, funksionet e policisë dhe procesin e ndalimit të personave nga anëtarë të UÇK-së.

99. Sa i përket cenimit të Mbrojtjes, Trupi Gjykues është bindur se vlera provuese e këtyre dokumenteve nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të tyre ndaj të akuzuarve. Mbrojtja do të ketë mundësinë të kundërshtojë përmbajtjen e këtyre materialeve përmes marrjes në pyetje të dëshmitarëve përkatës, ndër të cilët dhe W04746-ën dhe W04290-n.

100. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykues pranon si prova jogojore materialet U001-0504-U001-0504-RED, SPOE00119160-SPOE00119160, SITF0024242577-SITF00242577, U001-0399-U001-0400 dhe 056474-056474 dhe refuzon pranimin si prova jogojore të materialeve U017-3349-U017-3363 dhe U003-4775-U003-4784.

7. Kategoria 7: Dokumente të sekuestruara në shtëpitë e z. Krasniqi ose z.

Selimi

101. ZPS-ja kërkon pranimin si prova jोगojore të 20 dokumenteve, të cilat ajo pretendon se kanë lidhje me dëshmitë e W04746-ës dhe/ose W04290-s dhe të cilat u sekuestruan gjatë kontrollimit që ZPS-ja kreu në shtëpitë e z. Krasniqi dhe z. Selimi.¹²⁶

102. Mbrojtja kundërshton ligjshmërinë e sekuestrimeve të kryera në shtëpitë e z. Krasniqi dhe z. Selimi bazuar në: (i) mangësitë e pretenduara të inventarit; (ii) mosdhënien e një kopjeje në gjuhën shqipe të inventarit; (iii) mungesës së mbrojtësit gjatë kryerjes së kontrollit (një pjesë të tij) në shtëpinë e z. Krasniqi; dhe (iv) shkeljet e pretenduara të të drejtave të të akuzuarve.¹²⁷

103. Paraprakisht, Trupi Gjykues do të trajtojë aspektin nëse Mbrojtja është proceduralisht e autorizuar të kundërshtojë ligjshmërinë e operacioneve të kontrollimit dhe sekuestrimit në këtë fazë.

104. Në rregullën 39(1)(b) përcaktohet se:

në varësi të paragrafit (2), kontrollimi dhe sekuestrimi në bazë të rregullës 37 ose rregullës 38, kryhen prej Prokurorit të Specializuar në prani të personit përkatës dhe para kryerjes së kontrollimit dhe sekuestrimit ai

[...]

¹²⁶ **W04290:** 086833-086833 (ky material ka lidhje edhe me W04746), 043803-043803; *Shih* Shtojcën 1 të Mocionit për Pranimin e Provave Jogojore, materialet 37, 37A; SPOE00232092-00232094, SPOE00225221-SPOE00225223, SPOE00231386-SPOE00231387, SPOE00231388-SPOE00231389 dhe SPOE00232680-00232685; *Shih* Shtojcën 2 të Mocionit për Pranimin e Provave Jogojore, materialet 17A, 17B, 17C, 18-19; SPOE00232117-SPOE00232120, SPOE00231037-SPOE00231128, SPOE00230089-SPOE00230089, SPOE00230091-SPOE00230091, SPOE00230093-SPOE00230093, SPOE00227659-SPOE00227660, SPOE00226679-SPOE00226686, SPOE00226369-SPOE00226433, SPOE00226185-SPOE00226190 dhe SPOE00225799-SPOE00225799; *Shih* Shtojcën 6 të Mocionit për Pranimin e Provave Jogojore, materialet 217, 229, 232, 234, 236, 252, 258, 262, 266, 268; **W04746:** SPOE00229687-SPOE00229688, SPOE00228852-SPOE00228852 dhe SPOE00226662-SPOE00226674; *Shih* Shtojcën 6 të Mocionit për Pranimin e Provave Jogojore, materialet 238, 242, 260.

¹²⁷ Përgjigjja, para. 31-51.

(b) informon personin në fjalë për të drejtat e tij sipas rregullës 42 ose rregullës 43, si të jetë e zbatueshme;

105. Nga ana tjetër, rregulla 42(3) përcakton se:

çdo kundërshtim që paraqitet në lidhje me fletëthirrjet, urdhrat ose veprimet hetimore të Prokurorit të Specializuar mbi bazën se ndikojnë negativisht në të drejtat e një personi, i paraqitet gjykatësit të vetëm i cili caktohet sipas nenit 25(1)(f) të Ligjit, nëse nuk është caktuar panel. Kundërshtime të tilla paraqiten jo më vonë se një muaj nga njoftimi zyrtar për fletëthirrje, urdhra apo veprime hetimore të tilla dhe nga konfirmimi i personit në fjalë për vënien në dijeni.

106. Trupi Gjykues thekson se brenda afatit të përcaktuar në rregullën 42(3), nuk është paraqitur asnjë kundërshtim i tillë. Rrjedhimisht, mund të konsiderohet se z. Krasniqi dhe z. Selimi kanë hequr dorë nga e drejta që u jep Rregullorja për ta bërë këtë. Gjithashtu, Trupit Gjykues nuk i janë paraqitur të dhëna se ekzistojnë arsye të vlefshme që përlegjin kundërshtimin e ligjshmërisë së këtyre operacioneve.

107. Sidoqoftë, Trupi Gjykues ka vendosur të shqyrtojë themelësinë e kundërshtimeve të paraqitura nga Mbrojtja lidhur me ligjshmërinë e operacioneve të kontrollimit dhe sekuestrimit, për të siguruar dhe garantuar drejtësinë e procesit dhe integritetin e dokumentacionit.

108. Në lidhje me mangësitë e inventarit, Mbrojtja pretendon se kontrollimi dhe sekuestrimi i kryer në shtëpitë e z. Krasniqi dhe z. Selimi nuk përmbushi kriteret e rregullës 39 dhe shkeli të drejtat e të akuzuarve, sepse: (i) inventari ishte i paplotë, jo përmbajtjesor ose tepër i përgjithësuar;¹²⁸ (ii) në kohën e kryerjes së kontrollimit dhe sekuestrimit, të akuzuarve përkatës apo përfaqësuesve të tyre, nuk iu dha lista ku të tregohej çdo material konkret që ishte sekuestruar;¹²⁹ (iii) nuk

¹²⁸ Përgjigjja, para. 36.

¹²⁹ Përgjigjja, para. 36.

mund të bëhet krahasimi mes inventarit të përditësuar të dorëzuar më 28 prill 2021, dhe inventarit fillestar;¹³⁰ (iv) materialet e përshkruara si “grumbuj” dokumentesh shkelin kriterin e “përshkrimit të hollësishëm” të përcaktuar në rregullën 39(4);¹³¹ dhe (v) materialet e paraqitura për pranim si prova u nxorën nga skedarët elektronikë që përmbante “kompjuteri” i marrë në shtëpinë e z. Krasniqi, por nuk u përgatit asnjë inventar i dokumenteve të nxjerra nga këta skedarë dhe nuk u dorëzua asnjë shënim nga hetuesit ku të tregohej se ato dokumente u nxorën nga ai kompjuter.¹³²

109. Në lidhje me këto argumente, Trupi Gjykses vendos si më poshtë. Së pari, sikurse theksohet në çështjen *Gucati*, në përputhje me rregullën 138(1), dëshmia ose evidenca e kronologjisë së mbajtjes në ruajtje nuk është kusht për pranimin e provave.¹³³ Gjithashtu:

ekzistenca, konkretësia dhe besueshmëria e një evidence të tillë, në qoftë se ekziston, janë faktorë që kanë lidhje të mundshme me vlerësimin e kushteve të pranueshmërisë së provave të mbledhura. Trupi Gjykses gjithashtu vë në dukje se nuk ka konsensus ose standard ndërkombëtar lidhur me mënyrën dhe formën në të cilën duhet mbajtur evidenca e kronologjisë së mbajtjes në ruajtje të provave. Pranueshmëria e provave të mbledhura mund të ndikohet vetëm në qoftë se mangësitë e supozuara të kronologjisë së ruajtjes së provave ngrenë dyshime në lidhje me autenticitetin dhe/ose besueshmërinë e atyre provave. Sido që të jetë, besueshmëria dhe autenticiteti i provave të mbledhura gjatë një operacioni sekuestrimi gjithmonë duhen vlerësuar duke mbajtur parasysh të gjitha rrethanat përkatëse, e jo vetëm në bazë të evidencës zyrtare që është bërë, në qoftë se është bërë, gjatë operacionit të sekuestrimin.¹³⁴

¹³⁰ Përgjigjja, para. 37.

¹³¹ Përgjigjja, para. 38.

¹³² Përgjigjja, para. 43.

¹³³ KS-BC-2020-07, F00611/RED, Trupi Gjykses II, *Version i Redaktuar Publik i Aktgjykimit*, 18 maj 2022, para. 28.

¹³⁴ Po aty.

110. Mbrojtja ka paraqitur argumente në favor të një niveli konkretësie të inventarit që nuk kërkohet nga Rregullorja. Trupi Gjykues është bindur se evidencat e kontrollimeve përmbushin kriterin e rregullës 39(4) për një inventar me përshkrim të detajuar për secilin send të sekuestruar.

111. Lidhur me ankesën e dytë të Mbrojtjes, Rregullorja nuk kërkon që personit përkatës t'i jepet njëkohësisht edhe një kopje e inventarit të sendeve të sekuestruara në momentin e kryerjes së kontrollimit ose sekuestrimit (aq më pak në gjuhën shqipe). Sipas Rregullores kërkohet vetëm që kur është i pranishëm personi përkatës dhe mbrojtësi i tij, personi të nënshkruajë listën e inventarit dhe mund të bëjë edhe vërejtje me shkrim në lidhje me kryerjen e kontrollimit dhe sekuestrimit.¹³⁵ Kjo në rastin konkret është bërë.

112. Lidhur me ankesën e tretë, ZPS-ja nuk ishte e detyruar të jepte një inventar të përditësuar. Fakti që ZPS-ja e bëri këtë, është në favor e jo në dëm të Mbrojtjes. Rrjedhimisht, ankesat e Mbrojtjes lidhur me dukjen e përgjithshme dhe/ose formën e këtij inventari ose të evidencës plotësuese janë të parëndësishme për aspektin e ligjshmërisë së kontrollit të ushtruar.

113. Po kështu, kundërshtimi prej Mbrojtjes i përdorimit të termit “grumbuj” dokumentesh, është i pabazë. Ndonëse rregulla 39(4) kërkon që në inventar të dokumentohet secili “send i sekuestruar”, ky kriter duhet të interpretohet se nënkupton sendet e sekuestruara në një rast të caktuar, sasinë e tyre dhe gjendjen e materialit në momentin e sekuestrimit. Pasi të jenë gjetur në vendin e kontrollimit, për dokumentet duhet të mbahet evidencë në inventar. Në qoftë se ato gjenden në formën e një pakete ose grumbulli dokumentesh, përshkrimi i tyre si i tillë do të përmbushte kriterin e shënimit në listë të sendit të sekuestruar, të paraparë në rregullën 39(4).

¹³⁵ *Shih* rregullën 39(4).

114. Lidhur me ankesën e fundit, Trupi Gjykues thekson se, në kohën kur u krye sekuestrimi, ZPS-ja sekuestroi dhe futi në qese ose kuti të vulosura provash¹³⁶ të gjitha materialet dhe, rrjedhimisht, nuk ishte në gjendje të përcaktonte se cilat dokumente përmbante kompjuteri, nëse përmbante të tilla, dhe asaj i kërkohej vetëm të regjistronte dhe të shënonte në listë atë çka kishte sekuestruar, konkretisht kompjuterin. Rregullorja nuk kërkon që ZPS-ja të dorëzojë një inventar të veçantë të dokumenteve të nxjerra nga një kompjuter ose pajisje tjetër elektronike e sekuestruar. Gjithashtu, Mbrojtja nuk i është referuar ndonjë rregulle a parimi ligjor që zbatohet në këtë juridiksion, që kërkon që ZPS-ja ta bëjë këtë.

115. Sa i takon aspektit të gjuhës, Mbrojtja parashtron se inventari i sendeve të konfiskuara gjatë kontrollimit dhe sekuestrimit duhet të ishte përpiluar në gjuhën shqipe e jo në atë angleze. Rregulla 39 nuk përmban një kriter të tillë. Mbështetja e Mbrojtjes në rregullën 42(1)(c)¹³⁷ është e pabazë, pasi kjo rregull ka të bëjë me ndihmën e përkthyesit në kontekstin e marrjes në pyetje të personit.¹³⁸ Palët nuk pretendojnë se gjatë kontrollimeve dhe sekuestrimeve në fjalë ndodhi një marrje në pyetje e tillë.

116. Lidhur me praninë e mbrojtësit, rregulla 43(3) dhe (4) përcakton se:

3. Veprimet hetimore që kërkojnë praninë e të dyshuarit, veçanërisht marrja në pyetje, ballafaqimi, seanca e identifikimit ose rikonstruksioni i vendit të ngjarjes, nuk fillojnë pa praninë e mbrojtësit të specializuar. I dyshuari mund të heqë dorë nga kjo e drejtë nëse Prokurori i Specializuar sigurohet se i dyshuari e kupton rëndësinë e kësaj të drejte dhe pasojat e heqjes dorë prej saj. Kur e informon të dyshuarin për këtë të drejtë, Prokurori i Specializuar mban parasysh rrethanat personale të të dyshuarit, ndër të tjera moshën dhe gjendjen mendore e fizike të të dyshuarit. Heqja dorë nga kjo e drejtë dhe rrethanat e heqjes dorë nga

¹³⁶ F00095, Prokurori i Specializuar, *Raport i Prokurorisë mbi Kontrollimin dhe Sekuestrimin në zbatim të Vendimit KSC-BC-2020-06/F00031/COR* ("Raporti mbi Kontrollimin dhe Sekuestrimin e Kryer ndaj Krasniqit"), 19 nëntor 2020, konfidencial dhe *ex parte*, para. 8.

¹³⁷ Përgjigjja, para. 40, poshtëshënimi 76.

¹³⁸ *Shih gjithashtu rregullën 43(2).*

kjo e drejtë dokumentohen me shkrim prej Prokurorit të Specializuar dhe nënshkruhen prej të dyshuarit.

4. I dyshuari informohet se mund të kërkojë riaktivizimin e të drejtës së përfaqësimit në cilëndo fazë të marrjes në pyetje. Kur i dyshuari kërkon riaktivizimin e të drejtës së përfaqësimit, marrja në pyetje ndërpritet dhe rifillon vetëm në praninë e mbrojtësit të specializuar. Marrja në pyetje ose cilido veprim hetimor i kryer para riaktivizimit të së drejtës së përfaqësimit, mbetet i vlefshëm dhe nuk përsëritet.

117. Paraprakisht, Trupi Gjykues thekson se, sikurse është e qartë nga rregulla 39(2), nuk është e nevojshme që gjatë kontrollimit dhe sekuestrimit i dyshuari të jetë i pranishëm. Rregulla 43(3) kërkon praninë e mbrojtësit vetëm nëse një veprim hetimor kërkon praninë e të dyshuarit. Meqenëse sipas rregullës 39, për kryerjen e operacioneve të kontrollimit dhe sekuestrimit nuk kërkohet prania e të dyshuarit, kjo duhet të nënkuptojë se prania e mbrojtësit si e tillë nuk kërkohet.

118. Sidoqoftë, kur Rregullorja parasheh të drejtën për praninë e mbrojtësit, personi përkatës mund të heqë dorë nga kjo e drejtë. Trupi Gjykues është bindur se, në këtë rast, z. Krasniqi ka hequr dorë nga e drejta për të pasur mbrojtësin të pranishëm. Fillimisht, ai hoqi dorë nga mundësia për të pasur mbrojtësin të pranishëm (nga ora 8:26 deri në orën 10:34 të paradites).¹³⁹ Në orën 10:34 të paradites, mbërriti mbrojtësi i z. Krasniqi dhe z. Krasniqi bëri të ditur se dëshironte që mbrojtësi të ishte i pranishëm gjatë pjesës së mbetur të kontrollit. Mbrojtësit të tij iu dha një kopje e urdhrit për kontrollim dhe sekuestrim dhe ai nënshkroi për marrjen e urdhrit në orën 10:39. Mbrojtësi i z. Krasniqi u largua nga shtëpia në orën 11:46 dhe la një numër telefoni në të cilin ZPS-ja ra dakord ta kontaktonte kur të përfundonte kontrolli.¹⁴⁰ Në atë moment, z. Krasniqi nuk pati asnjë kundërshtim ndaj kësaj mënyre veprimi. Mbrojtësi i z. Krasniqi u kthye në

¹³⁹ Përgjigjja, para. 39; *Shih gjithashtu* Raportin mbi Kontrollimin dhe Sekuestrimin e Kryer ndaj Krasniqit, para. 4, 8-9.

¹⁴⁰ Raporti mbi Kontrollimin dhe Sekuestrimin e Kryer ndaj Krasniqit, para. 9.

shtëpinë e këtij të fundit në orën 14:39.¹⁴¹ As z. Krasniqi e as mbrojtësi i tij nuk shprehën kundërshtime për vazhdimin e kontrollit në ato rrethana dhe nuk e kundërshtuan atë në përputhje me rregullën 42(3). Në këto rrethana, Trupi Gjykses konstaton se fillimisht z. Krasniqi hoqi dorë nga e drejta e tij për të pasur mbrojtësin të pranishëm gjatë kontrollit dhe, më pas, e pati mbrojtësin të pranishëm kur kërkoi që ai të ishte i pranishëm.

119. Z. Selimi nuk ka paraqitur ndonjë kundërshtim të ngjashëm lidhur me praninë e mbrojtësit dhe Trupi Gjykses është bindur se kontrollimi i shtëpisë së tij është kryer në përputhje me Ligjin dhe Rregulloren.

120. Bazuar në sa më lart, Mbrojtja nuk ka vërtetuar se të drejtat e të akuzuarve ose integriteti i procesit janë cenuar thelbësisht në ndonjë masë nga mënyra në të cilën u kryen në këtë rast operacionet e kontrollimit dhe sekuestrimit.

121. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses do të shqyrtojë pranueshmërinë e materialeve të sekuestruara në shtëpitë e z. Krasniqi dhe z. Selimi. Trupi Gjykses, për aq sa ka qenë e mundur, ka bërë vlerësimin e 20 dokumenteve, duke përdorur të njëjtat kategori si ato të përshkruara më lart, konkretisht: (i) fotografi; (ii) libër; (iii) raporte në shtyp, artikuj në gazeta dhe intervista; (iv) dokument i nënshkruar nga W04290; (v) komunikata të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së; (vi) versione pune të deklaratave publike të UÇK-së; (vii) dokumente të shkruara me dorë të UÇK-së; dhe (viii) dokumente të tjera të UÇK-së.

(a) Fotografia

122. ZPS-ja kërkon pranimin e një fotografie të z. Selimi në shoqërinë e W04746-ës, e cila u konfiskua në shtëpinë e z. Selimi.¹⁴² ZPS-ja parashtrohet se fotografia

¹⁴¹ Raporti mbi Kontrollimin dhe Sekuestrimin e Kryer ndaj Krasniqit, para. 12.

¹⁴² **W04746**: SPOE00229687-SPOE00229688; *Shih* Shtojcën 6 të Mocionit për Pranimin e Provave Jogojore, materialin 238

është relevante, autentike e me vlerë provuese dhe se pranimi i saj nuk dëmton në mënyrë të papërligjur Mbrojtjen.¹⁴³

123. Mbrojtja kundërshton pranimin si provë jोगजore të një numri fotografish dhe videoincizimesh, pasi shumë prej tyre janë dorëzuar nga dëshmitarë të ZPS-së ose kanë lidhje me ta dhe, për rrjedhojë, duhet të paraqiten përmes dëshmitarit ose dëshmitarëve përkatës. Mbrojtja parashtrohet se jurisprudenca e krijuar tashmë përcakton se nuk duhet të pranohen si prova jोगजore fotografi dhe videoincizime, pa prova të pavarura dhe të pranueshme.¹⁴⁴

124. Trupi Gjykues vlerëson se në mungesë të hollësive të mëtejshme, si data, vendi ose elemente të tjera kontekstuale që i jep dëshmitari, relevanca e kësaj fotografie nuk është e qartë. Rrjedhimisht, Trupi Gjykues nuk do ta pranojë si provë jोगजore fotografinë.

125. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykues nuk refuzon pranimin si prove jोगजore të materialit SPOE00229687-SPOE00229688.

(b) Libri

126. ZPS-ja kërkon pranimin e një dorëshkrimi të pabotuar të titulluar “UÇK-ja në konferencën ndërkombëtare të Rambujesë për Kosovën dhe bombardimet e NATO-s” të shkurtit 2020, ku z. Krasniqi përmendet si autor i librit dhe i cili u sekuestrua në shtëpinë e tij.¹⁴⁵ ZPS-ja parashtrohet se ky dokument është relevant, autentik e me vlerë provuese dhe se pranimi i tij nuk dëmton në mënyrë të papërligjur Mbrojtjen.¹⁴⁶

¹⁴³ Mocioni për Pranimin e Provave Jोगजore, para. 3; *Shih* Shtojcën 6 të Mocionit për Pranimin e Provave Jोगजore, materialin 238.

¹⁴⁴ Përgjigjja, para. 95-96; *Shih gjithashtu* Shtojcën 6.8 të Përgjigjes, f. 2

¹⁴⁵ **W04290**: SPOE00231037-SPOE00231128; *Shih* Shtojcën 6 të Mocionit për Pranimin e Provave Jोगजore, materialin 229.

¹⁴⁶ Mocioni për Pranimin e Provave Jोगजore, para. 3.

127. Mbrojtja kundërshton pranimin si prova jोगोјore të librave.¹⁴⁷ Mbrojtja shton se ZPS-ja nuk ka demonstruar me qartësi se në çfarë aspekti dhe në çfarë mënyre libra të ndryshëm janë bërë pjesë e provave dhe argumenteve të saj dhe se ZPS-ja kërkon pranimin si prova jोगोјore të këtyre librave voluminozë, pa evidentuar në to pjesët relevante.¹⁴⁸

128. Trupi Gjykues konstaton se materiali SPOE00231037-SPOE00231128 është relevant, pasi ka të bëjë me pranimin e të akuzuarit në vende të ndryshme gjatë kuadrit kohor që mbulon Aktakuza, mjetet e komunikimit që kishin në dispozicion anëtarët e UÇK-së dhe detajet e rolit të z. Krasniqi dhe të tjerëve brenda UÇK-së.

129. Trupi Gjykues vlerëson se ky material përmban tregues të autenticitetit *prima facie*, si evidentimi që kuptohet nga brendia e tij i z. Krasniqi si autor, data përkuese dhe fakti se libri u gjet në shtëpinë e z. Krasniqi. Këto janë tregues të mjaftueshëm të autenticitetit *prima facie* të dokumentit.

130. Megjithatë, Trupi Gjykues nuk është bindur për vlerën provuese *prima facie* të librit, si dhe për besueshmërinë e materialit SPOE00231037-SPOE00231128. Në veçanti, Trupi Gjykues thekson se ky dokument është një version pune i një dorëshkrimi të pabotuar dhe, rrjedhimisht, pa kontekst të mëtjejshtë nga dëshmitari, vërtetësia e përmbajtjes së tij mbetet e paqartë. Gjithashtu, Trupi Gjykues thekson se ZPS-ja nuk ka evidentuar konkretisht në dorëshkrim pjesët në të cilat kërkon të mbështetet, gjë që do t'i kishte mundësuar Trupit Gjykues të jepte një vlerësim më konkret për vlerën provuese dhe besueshmërinë *prima facie* të pjesëve në fjalë.

131. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykues refuzon pranimin si provë jोगोјore të materialit SPOE00231037-SPOE00231128.

¹⁴⁷ Përgjigjja, para. 68; *Shih gjithashtu* Shtojcën 6.4 të Përgjigjes, f. 6-7.

¹⁴⁸ Përgjigjja, para. 70.

(c) Raportet në shtyp, artikujt në gazeta dhe intervistat

132. ZPS-ja kërkon pranimin e tre artikujve të botuara në gazetën “Gazeta Shqiptare”, në lidhje me W04290-n ose që përmbajnë deklarata që i atribuohen atij. Këta u sekuestruan në shtëpinë e z. Selimi.¹⁴⁹ ZPS-ja parashtrohet se këto dokumente janë relevante, autentike dhe me vlerë provuese dhe se pranimi i tyre nuk dëmton në mënyrë të papërligjur Mbrojtjen.¹⁵⁰

133. Mbrojtja kundërshton pranimin si prova jोगojore të intervistave ndërmjet dëshmitarëve të ZPS-së dhe palëve të treta. Mbrojtja parashtrohet se rreziku që këto materiale të jenë bërë objekt i analizës apo interpretimit nga ana e gazetarëve, apo të jenë manipuluar në ndonjë mënyrë tjetër, shtron nevojën që të akuzuarit t’i jepet mundësia të verifikojnë vërtetësinë e përmbajtjes së tyre.¹⁵¹ Mbrojtja gjithashtu kundërshton pranimin si prova jोगojore të artikujve të botuar në media, në të cilët UÇK-së ose të akuzuarit i atribuohen deklarata, për faktin se Mbrojtja nuk ka mundësi të bëjë pyetje në lidhje me këto deklarata të bëra jashtë sallës së gjyqit dhe rrethanat në të cilat janë bërë ato.¹⁵²

134. Trupi Gjykes konstaton se këto tri materiale janë relevante, pasi ato kanë të bëjnë, ndër të tjera, me veprimtaritë e kryera në zonat operative të Drenicës dhe me organizimin dhe strukturën e UÇK-së.¹⁵³

135. Në lidhje me autenticitetin, Trupi Gjykes gjykon se të gjitha materialet përmbajnë tregues të autenticitetit *prima facie*, pasi kanë data dhe janë botuar në “Gazeta Shqiptare”.

136. Gjithashtu, Trupi Gjykes është bindur se këto materiale kanë vlerë provuese *prima facie* për faktet që kanë lidhje me këtë çështje. Sidoqoftë, gjatë ushtrimit të

¹⁴⁹ **W04290**: SPOE00230089-SPOE00230089, SPOE00230091-SPOE00230091 dhe SPOE00230093-SPOE00230093; *Shih* Shtojcën 6 të Mocionit për Pranimin e Provave Jोगojore, materialet 232, 234, 236.

¹⁵⁰ Mocioni për Pranimin e Provave Jोगojore, para. 3.

¹⁵¹ Përgjigjja, para. 56; *Shih gjithashtu* Shtojcën 6.3 të Përgjigjes, f.6-7.

¹⁵² Përgjigjja, para. 59-60.

¹⁵³ Aktakuza, para. 35, 41.

kompetencës së vet diskrecionale dhe për të mos lejuar që Mbrojtja të dëmtohet, Trupi Gjykses vlerëson se vendimi mbi pranimin e këtyre materialeve duhet të merret pasi të jetë dhënë dëshmia e W04290-s, kohë kjo kur do të mund të verifikohet në mënyrë të plotë përmbajtja e këtyre dokumenteve.

137. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses refuzon pranimin si prova jogojore të materialeve SPOE00230093-SPOE00230093, SPOE00230091-SPOE00230091 dhe SPOE00230089-SPOE00230089.

(d) Dokumenti i nënshkruar nga W04290

138. ZPS-ja kërkon pranimin si provë jogojore të një “kërkese për kompensim” të nënshkruar nga W04290, e cila u sekuestrua në shtëpinë e z. Krasniqi.¹⁵⁴ ZPS-ja parashtron se ky dokument është relevant, autentik e me vlerë provuese dhe se pranimi i tij nuk dëmton në mënyrë të papërligjur Mbrojtjen.¹⁵⁵

139. Mbrojtja përgjigjet se dokumentet që janë të lidhura me dëshmitarët e ZPS-së, duhet të paraqiten përmes dëshmitarit përkatës, në përputhje me parimin e paraqitjes së dëshmive gojore.¹⁵⁶

140. Trupi Gjykses konstaton se materiali SPOE00225799-SPOE00225799 është relevant pasi ka të bëjë me kërkesën për kompensim lidhur me shpenzimet e personelit që W04290, si komandant i zonës operative të Drenicës, i ka drejtuar Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së. Kjo, nga ana tjetër, lidhet me aspektin e organizimit dhe funksionimit të UÇK-së.

¹⁵⁴ SPOE00225799-SPOE00225799; *Shih* Shtojcën 6 të Mocionit për Pranimin e Provave Jogojore, materialin 268.

¹⁵⁵ Mocioni për Pranimin e Provave Jogojore, para. 3.

¹⁵⁶ *Shih më lart*, para. 61; Përgjigja, para. 52; *Shih gjithashtu* Shtojcën 6.2.1 të Përgjigjes, f. 35-36.

141. Në lidhje me autenticitetin, Trupi Gjykses vlerëson se dokumenti është *prima facie* autentik, pasi ka datë, është i nënshkruar nga W04290 si komandant i zonës operative të Drenicës dhe ka shënime që vërtetojnë prejardhjen e tij.

142. Trupi Gjykses gjithashtu është bindur se materiali ka vlerë provuese *prima facie*. Ai lidhet me rolin dhe përgjegjësitë e W04290-s si komandant i zonës operative të Drenicës dhe ofron prova për faktet e përshkruara më lart..

143. Sa i përket cenimit të Mbrojtjes, Trupi Gjykses është bindur se vlera provuese e këtij dokumenti nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të tij ndaj të akuzuarit. Mbrojtja do të ketë mundësinë t'i bëjë pyetje W04290-s në lidhje me këtë dokument.

144. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses pranon si provë jogjore materialin SPOE00225799-SPOE00225799.

(e) Komunikatat e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së

145. ZPS-ja kërkon pranimin si prova të dy komunikatave të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, të botuara fillimisht në gazetat "Koha Ditore" dhe "Zëri i Kosovës", versionet përkatëse të të cilave u sekuestruan në shtëpinë e z. Krasniqi.¹⁵⁷ ZPS-ja parashtron se këto dokumente janë relevante, autentike dhe me vlerë provuese dhe se pranimi i tyre nuk dëmton në mënyrë të papërligjur Mbrojtjen.¹⁵⁸

146. Mbrojtja kundërshton pranimin si prova jogjore të këtyre komunikatave, me argumentin se, duke qenë se disa janë të panënshkruara, të pavulosura dhe nuk kanë datë, nuk u dihet autorësia, është e paqartë se mbi bazën e çfarë informacionesh janë përpiluar dhe versionet "origjinale" të tyre nuk disponohen,

¹⁵⁷ **W04290**: 086833-086833 (ky material ka lidhje edhe me W04746) dhe 043803-043803; *Shih* Shtojcën 1 të Mocionit për Pranimin e Provave Jogjore, materialet 37, 37A.

¹⁵⁸ Mocioni për Pranimin e Provave Jogjore, para. 3.

këto dokumente, pa u dhënë kontekst nga dëshmitari, nuk përmbushin kriteret për t'u pranuar si prova.¹⁵⁹

147. Fillimisht, Trupi Gjykses thekson se, ndonëse ZPS-ja nuk ka përcaktuar se materialet 086857-086857 dhe 086866-086866, të cilat gjithashtu u sekuestruan në shtëpinë e z. Krasniqi, kanë lidhje me ndonjërin prej dëshmitarëve të përmendur në këtë vendim, këto materiale janë të lidhura ngushtë me materialet 043802-043802 dhe 043805-043805 të trajtuara më lart në paragrafët 72-77. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses do t'i trajtojë këto materiale në këtë vendim.

148. Trupi Gjykses rikujton se çështja e autorësisë së këtyre dokumenteve duhet të zgjidhet në gjykim, sikurse përcaktohet në paragrafin 71 më lart.

149. Trupi Gjykses konstaton se katër komunikatat janë deklarata publike të bëra nga UÇK-ja dhe arrin në përfundimin se ato janë relevante për aspekte të ndryshme të kësaj çështjeje, ndër to dhe pretendimi për ekzistencën e një konflikti të armatosur, pretendimi për vënien në shënjestër të bashkëpunëtorëve dhe kundërshtarëve dhe për legjitimitimin e sulmeve ndaj tyre dhe pretendimi për krimet e kryera në Qirez dhe Baicë.¹⁶⁰

150. Në lidhje me autenticitetin, Trupi Gjykses është bindur se këto dokumente janë *prima facie* autentike. Komunikatat fillimisht u publikuan në gazetën "Zëri i Kosovës" dhe/ose "Koha Ditore". ZPS-ja ka dhënë datat e publikimit dhe komunikatat kanë numra e disa prej tyre konfirmojnë njëra-tjetrën.¹⁶¹ Trupi Gjykses nuk ka asnjë të dhënë që kundërshton vërtetësinë e tyre.

151. Gjithashtu, Trupi Gjykses është bindur se ato kanë vlerë provuese *prima facie* në lidhje me faktet relevante për këtë çështje. Ato janë komunikata të publikuara në emër të UÇK-së. Sikurse u theksua më herët, përmbajtja e disave prej tyre

¹⁵⁹ Përgjigjja, para. 17; *Shih gjithashtu* Shtojcën 1 të Përgjigjes, f. 141-143.

¹⁶⁰ Aktakuza, para. 17-20, 37, 39-40, 110-111.

¹⁶¹ *Shih për shembull*, Shtojcën 6 të Mocionit për Pranimin e Provave Jogojore, materialet 2M, 35-36, 37A, 39A, 40 ku: (i) materialet 2M dhe 37A; (ii) materialet 35 dhe 36; dhe (iii) materialet 39A dhe 40, konfirmojnë njëri-tjetrin.

tashmë është konfirmuar. Trupi Gjykses nuk ka asnjë të dhënë që do të ngrinte dyshime në lidhje me vlerën provuese dhe besueshmërinë *prima facie* të këtyre dokumenteve. Në përfundim të procesit gjyqësor do të vlerësohet, bazuar në të gjitha provat relevante, se çfarë peshe dhe vlere provuese mund t'u jepet komunikatave.

152. Sa i përket cenimit të Mbrojtjes, Trupi Gjykses është bindur se vlere provuese e këtyre dokumenteve nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të tyre ndaj të akuzuarve. Në veçanti, Trupi Gjykses thekson se Mbrojtja do të ketë mundësinë të kundërshtojë përmbajtjen e këtyre materialeve përmes marrjes në pyetje të dëshmitarëve përkatës të ZPS-së.

153. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses pranon si prova jogojore materialet 086833-086833, 043803-043803, 086857-086857 dhe 086866-086866.

(f) Versionet e punës të deklaratave publike të UÇK-së

154. ZPS-ja kërkon pranimin e pesë materialeve që janë versione pune të deklaratave publike të UÇK-së, të sekuestruara në shtëpinë e z. Krasniqi.¹⁶² ZPS-ja parashtrohet se këto dokumente janë relevante, autentike dhe me vlerë provuese dhe se pranimi i tyre nuk dëmton në mënyrë të papërligjur Mbrojtjen.¹⁶³

155. Mbrojtja kundërshton pranimin si prova të këtyre dokumenteve që pretendohet se janë versione pune të deklaratave politike dhe komunikatave, në mungesë të dëshmitarit që do të vërtetonte relevancën, vlerën provuese dhe mbështetshmërinë e tyre.¹⁶⁴ Gjithashtu, Mbrojtja parashtrohet se këto dokumente nuk përmbajnë tregues të nevojshëm të relevancës dhe autenticitetit dhe se TPNJ-ja ka konstatuar se versionet e punës për të cilat nuk mund të provohet autorësia apo të cilave u mungojnë vulat, nënshkrimet apo tregues të tjerë zyrtarë, nuk

¹⁶² **W04290**: SPOE00232092-00232094, SPOE00225221-SPOE00225223, SPOE00231386-SPOE00231387, SPOE00231388-SPOE00231389 dhe SPOE00232680-00232685; *Shih* Shtojcën 2 të Mocionit për Pranimin e Provave Jogojore, materialet 17A, 17B, 17C, 18-19.

¹⁶³ Mocioni për Pranimin e Provave Jogojore, para. 3.

¹⁶⁴ Përgjigjja, para. 25; *Shih gjithashtu* Shtojcën 2 të Përgjigjes, f. 69-79.

duhet të pranohen në dokumentacionin e çështjes.¹⁶⁵ Mbrojtja shton se autorësia nuk mund të supozohet për shkak të vendit ku u sekuestruan materialet, se ZPS-ja nuk ka provuar se versionet e punës të dokumenteve u përpiluan para versioneve të publikuara dhe se, në mungesë të përcaktimit të autenticitetit të tyre dhe të provave që vërtetojnë se autor i tyre është z. Krasniqi, atyre u mungon vlera provuese e nevojshme.¹⁶⁶ Së fundi, Mbrojtja parashtrohet se vlera provuese e tyre zhbëhet prej efektit dëmtues ndaj të akuzuarit pasi pranimi i tyre si prova jोगojore ia pamundëson Mbrojtjes t'i bëjë pyetje dëshmitarit në lidhje me autenticitetin dhe autorësinë e tyre.¹⁶⁷

156. Trupi Gjykses vë në dukje se Mbrojtja vë në dyshim autorësinë e këtyre dokumenteve, por gjykon se fakti që vihet në dyshim autorësia nuk e pengon pranimin e tyre si prova jोगojore. Përkundrazi, çështja e autorësisë së dokumenteve dhe nëse ato i atribuohen të akuzuarit, do të zgjidhet në gjykim. Për pranimin e tyre si prova, mjafton të vërtetohet se dokumentet e propozuara janë relevante dhe *prima facie* autentike e me vlerë provuese.

157. Ndonëse gjatë konferencës mbi ecurinë e çështjes të 20 marsit 2023,¹⁶⁸ ZPS-ja dha sqarime shtesë për materialin SPOE00232092-00232094, Trupi Gjykses ende nuk është bindur për relevancën e këtij materiali pa u ofruar kontekst i mëtjshëm. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses nuk do ta pranojë këtë material si provë jोगojore në këtë fazë të procesit.

158. Trupi Gjykses konstaton se katër materialet e mbetura janë relevante për akuzat, pasi, ndër të tjera, ato kanë të bëjnë me: (i) versionet e punës të deklaratave të bëra nga UÇK-ja në lidhje me krimet në Qirez, për të cilat janë ngritur akuza; (ii) dijeninë që anëtarë të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së mund të kenë pasur për këto krime; (iii) politikën e pretenduar të shënjestrimit të atyre që

¹⁶⁵ Përgjigjja, para. 26.

¹⁶⁶ Përgjigjja, para. 27-29.

¹⁶⁷ Përgjigjja, para. 30.

¹⁶⁸ Transkripti i seancës, 20 mars 2023, f. 2066, rreshti 2 deri në f. 2067, rreshti 22.

konsideroheshin si kundërshtarë; (iv) procesin e hartimit të komunikatave në emër të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së; dhe (v) elementët e konfliktit të armatosur jondërkombëtar të pretenduar.¹⁶⁹

159. Në lidhje me autenticitetin e dokumenteve, Trupi Gjykses vlerëson se dokumentet janë *prima facie* autentike. Ato kanë data, përgjithësisht përputhen me versionet e publikuara në gazetën “Zëri i Kosovës”,¹⁷⁰ dhe janë gjetur në shtëpinë e një prej të akuzuarve.

160. Trupi Gjykses është bindur se këto materiale kanë vlerë provuese *prima facie*. Ato ofrojnë prova *prima facie* të besueshme që janë relevante për vërtetimin e fakteve dhe rrethanave thelbësore për këtë çështje gjyqësore.¹⁷¹ Në përfundim të procesit gjyqësor do të vlerësohet, duke marrë parasysh provat në tërësi, se çfarë peshe dhe vlere provuese, nëse kanë, mund t’u jepet këtyre materialeve.

161. Sa i përket cenimit të Mbrojtjes, Trupi Gjykses është bindur se vlere provuese e materialeve të mbetura nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të tyre ndaj të akuzuarit. Në veçanti, Trupi Gjykses thekson se me këtë vendim pranohen variantet e publikuara të komunikatave në version pune dhe Mbrojtja do të mund t’u bëjë pyetje dëshmitarëve të ZPS-së në lidhje me secilin prej këtyre materialeve.

162. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses, në këtë fazë të procesit, pranon si prova jogojore materialet SPOE00225221-SPOE00225223, SPOE00231386-SPOE00231387, SPOE00231388-SPOE00231389 dhe SPOE00232680-00232685 dhe refuzon pranimin si provë jogojore të materialit SPOE00232092-00232094.

¹⁶⁹ Aktakuza, para. 18-20, 31-32, 36-39, 76, 110-111.

¹⁷⁰ *Shih më lart*, para. 77, 153; *Shih gjithashtu* Shtojcën 1 të Mocionit për Pranimin e Provave Jogojore, materialet 35, 36, 37A.

¹⁷¹ *Shih më lart*, para. 158.

(g) Dokumentet e shkruara me dorë të UÇK-së

ZPS-ja kërkon pranimin e tri dokumenteve të shkruara me dorë të sekuestruara në shtëpinë e z. Selimi, përmbajtja e të cilave ka lidhje me UÇK-në.¹⁷² Dokumenti i parë është një raport që përmban hollësi në lidhje me brigada të ndryshme brenda zonës operative të Drenicës.¹⁷³ Dokumenti i dytë përmban shënime mbi inspektimet e kryera në zona të ndryshme operative.¹⁷⁴ Dokumenti i tretë përmban shënime për takime të ndryshme, ndër to dhe takimet me përfaqësues të huaj dhe personelin e UÇK-së.¹⁷⁵ ZPS-ja parashtrohet se dokumentet e shkruara me dorë janë relevante, autentike dhe me vlerë provuese dhe se pranimi i tyre nuk dëmton në mënyrë të papërligjur Mbrojtjen.¹⁷⁶

163. Mbrojtja përgjigjet se këto dokumente duhet të paraqiten vetëm përmes autorëve të tyre përkatës,¹⁷⁷ se nuk dihet burimi origjinal i dokumenteve, se ato nuk janë autentike, nuk lidhen mjaftueshëm me veprat penale ose format e përgjegjësisë penale të paraqitura në Aktakuzë, dhe se efekti dëmtues i tyre zhbën në një masë të konsiderueshme vlerën provuese të tyre.¹⁷⁸

164. Trupi Gjykes vlerëson se këto tre materiale janë relevante. Ato, ndër të tjera, kanë të bëjnë me: (i) detaje të veprimtarive të brigadave të ndryshme në zonën operative të Drenicës; (ii) funksionimin e hierarkisë komanduese brenda UÇK-së; (iii) inspektimet dhe mbledhjet e zhvilluara gjatë periudhës nëntor 1998 – mars

¹⁷² **W04290**: SPOE00226679-SPOE00226686; *Shih* Shtojcën 6 të Mocionit për Pranimin e Provave Jogojore, materialin 258. SPOE00226369-SPOE00226433; *Shih* Shtojcën 6 të Mocionit për Pranimin e Provave Jogojore, materialin 262. **W04746**: SPOE00226662-SPOE00226674; *Shih* Shtojcën 6 të Mocionit për Pranimin e Provave Jogojore, materialin 260.

¹⁷³ SPOE00226679-SPOE00226686; *Shih* Shtojcën 6 të Mocionit për Pranimin e Provave Jogojore, materialin 258

¹⁷⁴ SPOE00226662-SPOE00226674; *Shih* Shtojcën 6 të Mocionit për Pranimin e Provave Jogojore, materialin 260

¹⁷⁵ SPOE00226369-SPOE00226433; *Shih* Shtojcën 6 të Mocionit për Pranimin e Provave Jogojore, materialin 262.

¹⁷⁶ Mocioni për Pranimin e Provave Jogojore, para. 3.

¹⁷⁷ Përgjigjja, para. 52-55.

¹⁷⁸ Përgjigjja, para. 97-101; *Shih gjithashtu* Shtojcën 6.1 të Përgjigjes, f. 47-49; Shtojcën 6.2.1 të Përgjigjes, f. 34-35.

1999, të cilat mund të jenë relevante për të kuptuar nivelin e organizimit, hierarkinë komanduese dhe format e përgjegjësisë penale; dhe (iv) shpërndarjen e përgjegjësiive ndërmjet zonave operative dhe Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së.¹⁷⁹

165. Në lidhje me autenticitetin, Trupi Gjykses vlerëson se dokumentet janë *prima facie* autentike. Ato kanë data dhe disa janë të nënshkruara nga W04290. Të gjitha dokumentet janë sekuestruar në shtëpinë e z. Selimi.

166. Trupi Gjykses është bindur se ato kanë të gjitha tregues të mjaftueshëm të vlerës provuese *prima facie* për përmbushjen e standardit të pranueshmërisë. Sidoqoftë, Trupi Gjykses thekson se çështja e autorësisë së tyre dhe nëse nënshkrimet në to u përkasin personave konkretë, është një aspekt që do të sqarohet në gjykim dhe vendimin në lidhje me të Trupi Gjykses do ta marrë në fund të procesit gjyqësor, në qoftë se për provat dhe argumentet e ZPS-së do të jenë vërtet thelbësore për përcaktimin se cili person është autori i këtyre dokumenteve. Trupi Gjykses gjithashtu thekson se këto dokumente janë të shkruara me dorë, se autorësia e tyre ende mbetet çështje e pasqaruar dhe se në këtë fazë, burimi i një pjese të informacionit që përmbajnë dokumentet është i paverifikuar. Të gjitha këto elemente ndikojnë në peshën dhe vlerën provuese që Trupi Gjykses mund të jetë i gatshëm t'u japë këtyre dokumenteve, përveç në qoftë se ato konfirmohen nga materiale të tjera dhe u jepet kontekst i mëtejshëm.

167. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses pranon si prova jogojore materialet SPOE00226679-SPOE00226686, SPOE00226662-SPOE00226674 dhe SPOE00226369-SPOE00226433.

(h) Dokumente të tjera të UÇK-së

168. ZPS-ja kërkon pranimin si prova jogojore të katër dokumenteve të tjera që kanë lidhje me UÇK-në, konkretisht: (i) një raport të Drejtorisë së Operacioneve

¹⁷⁹ Aktakuza, para. 19, 37, 39, 57.

të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së drejtuar shefit të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, ku trajtohet gatishmëria e njësive të UÇK-së;¹⁸⁰ (ii) një urdhri të Shtabit të Përgjithshëm për arrestimin e qytetarëve që tregojnë besnikëri ndaj Serbisë;¹⁸¹ (iii) një letre në version pune të shkruar nga W04290 në lidhje me një artikull të botuar në gazetën “Bota Sot”, ku sqarohen rolet e anëtarëve të UÇK-së;¹⁸² dhe (iv) procesverbalit të një mbledhjeje të datës 18 shkurt 2001 në “shtëpinë e Jasharëve” në Prekaz, në të cilën, ndër të tjerë, morën pjesë të akuzuarit dhe W04290, e ku u diskutua krijimi i UÇK-së.¹⁸³ ZPS-ja parashtron se këto dokumente janë relevante, autentike dhe me vlerë provuese dhe se pranimi i tyre nuk dëmton në mënyrë të papërligjur Mbrojtjen.¹⁸⁴

169. Mbrojtja përgjigjet se këto dokumente duhet të paraqiten vetëm përmes autorëve të tyre përkatës,¹⁸⁵ se nuk dihet burimi origjinal i dokumenteve, se ato nuk janë autentike, nuk lidhen mjaftueshëm me veprat penale ose format e përgjegjësisë penale të paraqitura në Aktakuzë, dhe se efekti dëmtues i tyre zhbën në një masë të konsiderueshme vlerën provuese të tyre.¹⁸⁶

170. Trupi Gjykues konstaton se këto materiale janë relevante për një sërë aspektesh të kësaj çështjeje gjyqësore, ndër të cilat: (i) operacionet dhe funksionimi i UÇK-së dhe hierarkia komanduese e saj; dhe (ii) roli, funksionet dhe përgjegjësitë e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së.¹⁸⁷

¹⁸⁰ **W04290**: SPOE00232117-SPOE00232120; *Shih* Shtojcën 6 të Mocionit për Pranimin e Provave Jogojore, materialin 217.

¹⁸¹ **W04746**: SPOE00228852-SPOE00228852; *Shih* Shtojcën 6 të Mocionit për Pranimin e Provave Jogojore, materialin 242.

¹⁸² **W04290**: SPOE00227659-SPOE00227660; *Shih* Shtojcën 6 të Mocionit për Pranimin e Provave Jogojore, materialin 252.

¹⁸³ **W04290**: SPOE00226185-SPOE00226190; *Shih* Shtojcën 6 të Mocionit për Pranimin e Provave Jogojore, materialin 266.

¹⁸⁴ Mocioni për Pranimin e Provave Jogojore, para. 3.

¹⁸⁵ Përgjigja, para. 52-55.

¹⁸⁶ *Shih* Shtojcën 6.1 të Përgjigjes, f.31-33, 40, 50-52; Shtojcën 6.2.1. të Përgjigjes, f. 34.

¹⁸⁷ Aktakuza, para. 37, 39.

171. Trupi Gjykues është bindur se këto dokumente janë *prima facie* autentike. Ato janë hartuar si shkresa me emërtime zyrtare në krye të tyre dhe përmbajnë tregues të tjerë të autenticitetit, si numrin e referencës, vendin, datën, vulën, vendin ku vihet nënshkrimi, emrat e personave përkatës dhe/ose nënshkrimet e tyre. Të gjitha këto dokumente janë sekuestruar në shtëpinë e z. Krasniqi.

172. Në lidhje me vlerën provuese të këtyre materialeve, Trupi Gjykues thekson se materiali SPOE00232117-00232120 ka vlerë provuese *prima facie* për aspekte të ndryshme të kësaj çështjeje gjyqësore, ndër të cilat hierarkia dhe funksionimi i UÇK-së, roli dhe përgjegjësitë e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së në atë kontekst, përfshirja e tij në operacione, informacioni që ai dispononte dhe elementë të ndryshëm organizativë që kishin të bënin me UÇK-në. Ky material mban nënshkrimin e W04752-shit. Megjithatë, materiali nuk ka as datë e as numër. Gjithashtu, Trupi Gjykues në këtë fazë nuk ka të dhëna se ky dokument është lëshuar. Ai mbetet me vlerë provuese për informacionin që përmban. Gjithsesi, do të duhet që pretendimi i ZPS-së se ky dokument është lëshuar dhe zbatuar, të vërtetohet në gjykim.

173. Lidhur me vlerën provuese të materialit SPOE00226185-SPOE00226190, Trupi Gjykues thekson se ai është procesverbal i nënshkruar i mbledhjes së mbajtur më 18 shkurt 2001 në Prekaz. Mes pjesëmarrësve në të ishin z. Thaçi, z. Veseli dhe W04290. Në të është shënuar se të tre këta kanë bërë deklaratë, disa prej të cilave janë relevante për procesin aktual (përfshirë në lidhje me rrethanat e krijimit të UÇK-së, rolin e tyre brenda saj, publikimin e librave nga njëri prej të akuzuarve). Vlera provuese *prima facie* e këtij materiali vërtetohet, ndër të tjera, edhe nga përmbajtja e procesverbalit, data dhe vendi i zhvillimit të mbledhjes dhe evidentimi i pjesëmarrësve.

174. Në lidhje me vlerën provuese të materialit SPOE00227659-SPOE00227660, Trupi Gjykues thekson se ky material është një letër e dy personave drejtuar gazetës "Bota Sot". Si dhe në rastet e dy dokumenteve të përmendura më herët,

letra u sekuestrua në shtëpinë e z. Krasniqi. Ndonëse ZPS-ja pretendon se letra ishte publikuar në një gazetë, ajo nuk paraqiti një kopje të gazetës në të cilën thuhet se ishte botuar dokumenti. Në të bëhet fjalë për një debat publik ndërmjet anëtarëve të lartë të UÇK-së që lindi nga një komunikatë e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, e cila përmbante akuza kundër një personi konkret. Vlera provuese e saj është e dukshme nga një sërë faktorësh, ndër të cilët: burimi, autorësia e saj, dhe fakti se një kopje e saj u gjet në shtëpinë e z. Krasniqi, fakti se ajo është një prej disa deklaratave publike të bëra prej anëtarëve të UÇK-së në lidhje me incidentin e përmendur në të. Në këtë kontekst, Trupi Gjykses gjithashtu thekson se W04290 është dëshmitar i propozuar nga ZPS-ja.

175. Sa i përket materialit SPOE00228852-SPOE00228852, Trupi Gjykses vlerëson se ai ka vlerë provuese *prima facie*. Në veçanti, materiali ofron prova relevante, ndër të tjera, për pretendimin se ekzistonte një politikë e shënjestrimit të atyre që ishin kundër UÇK-së, përfshirjen e pretenduar të Shtabit të Përgjithshëm në zbatimin e një politike të tillë, përdorimin e hierarkisë komanduese të UÇK-së në zbatimin e kësaj politike, dhe, rrjedhimisht, format e pretenduara të përgjegjësisë penale.

176. Sa i përket cenimit të Mbrojtjes, Trupi Gjykses është bindur se vlera provuese e materialeve SPOE00232117-00232120, SPOE00227659-SPOE00227660, SPOE00226185-SPOE00226190 dhe SPOE00228852-SPOE00228852 nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të tyre ndaj të akuzuarve. Në veçanti, Mbrojtja do të ketë mundësinë të kundërshtojë përmbajtjen e këtyre materialeve përmes marrjes në pyetje të dëshmitarëve të ZPS-së. Fakti që një nga këto dokumente është nënshkruar nga z. Krasniqi, nuk e ndryshon këtë konstatim.

177. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses pranon si prova jogojore materialet SPOE00228852-SPOE00228852, SPOE00232117-00232120, SPOE00227659-SPOE00227660 dhe SPOE00226185-SPOE00226190.

C. VLERËSIMI I PESHËS SË DOKUMENTEVE TË PRANUARA

178. Trupi Gjykses thekson se të gjitha materialet e propozuara, për të cilat në këtë vendim ka konstatuar se janë të pranueshme, përmbushin kriteret për pranim sipas rregullës 138(1). Megjithatë, pranimi si provë nuk është njëloj me përcaktimin e peshës, nëse ka, që Trupi Gjykses do t'i japë një prove. As përcaktimi prej Trupit Gjykses i vlerës provuese *prima facie* nuk është i njëjtë me vlerësimin e vlerës provuese të provës që Trupi Gjykses bën në përfundim të gjykimit. Sipas rregullës 139(2), kërkohet që Trupi Gjykses të vlerësojë secilën provë duke mbajtur parasysh tërësinë e provave të administruara në gjykim, dhe të bëjë një vlerësim dhe peshim tërësor duke i marrë provat në tërësi, për të parë nëse janë vërtetuar pretendimet faktike. Rrjedhimisht, ndonëse Trupi Gjykses në këtë vendim ka konstatuar se materialet janë të pranueshme, vlerësimin përfundimtar të peshës që do t'u jepet këtyre materialeve ai do ta bëjë duke mbajtur parasysh tërësinë e provave të administruara në gjykim.

V. KLASIFIKIMI

179. Trupi Gjykses thekson se Raporti mbi Kontrollimin dhe Sekuestrimin e Kryer ndaj Krasniqit (F00095), aktualisht është i klasifikuar si konfidencial dhe *ex parte*. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses urdhëron ZPS-në të shqyrtojë nëse mund të dorëzojë një version të redaktuar konfidencial ose të kërkojë riklasifikimin e Raportit.

VI. VENDIM

180. Për arsyet e lartpërmendura, Trupi Gjykses:

- a) **MIRATON**, pjesërisht Mocionin për Pranimin e Provave Jogojore në lidhje me dokumentet të cilat ZPS-ja i ka evidentuar si dokumente që

kanë lidhje me W04746-ën, W01236-ën dhe W04290-n;

- b) **PRANON** si prova jogojore materialet: SPOE00056463-SPOE00056463, SPOE00054513-SPOE00054514, SPOE00054318-SPOE00054320, SPOE00054878-SPOE00054879, 008555-008555-ET, SPOE00054898-SPOE00054902-ET, 008557-008559, SPOE00054519-SPOE00054522-ET, 007948-007949-ET, SITF00384552-00384553, SPOE00120826-00120838-RED, 068263-068267, U001-7883-U001-7883, U000-8212-U000-8219, U000-8056-U000-8056, U000-8034-U000-8034, U000-8005-U000-8005, U000-7979-U000-7998, U000-7909-U000-7909, U000-7887-U000-7888, U000-7885-U000-7885, U000-7874-U000-7874, U000-7868-U000-7868, U000-7862-U000-7862, U000-7849-U000-7849, U000-7811-U000-7811, U000-7778-U000-7778, U000-7777-U000-7777, U000-7720-U000-7720, U000-7718-U000-7718, U000-7691-U000-7691, U000-7650-U000-7650, U000-1654-U000-1654, U000-1649-U000-1649, U000-1436-U000-1436, SPOE00225798-SPOE00225798, SITF00240682-00240682, IT-05-87 4D00037, IT-04-84 P00231, 096318-096335, U001-0291-U001-0292, U000-2142-U000-2142-ET, SITF00242138-SITF00242141, SITF00069016-SITF00069016, 099824-099827, U016-2743-U016-2743-EDT, U016-2735-U016-2735-ET Rishikuar, IT-04-84 P00966.E, U008-1614-U008-1614-AT, 086833-086833-ET, 043802-043802, 043805-043805, 043861-043861, 043800-043800 (për qëllimet e përcaktuara në paragrafin 77), 051864-051865 (për qëllimet e përcaktuara në paragrafin 77), U000-9272-U000-9286, IT-05-87.1 P00436, U002-2800-U002-2822, U000-9858-U000-9888, U000-9349-U000-9364, U001-0504-U001-0504-RED, SPOE00119160-SPOE00119160, SITF0024242577-SITF00242577, U001-0399-U001-0400, 056474-056474, SPOE00225799-SPOE00225799, 086833-086833, 043803-043803, 086857-086857, 086866-086866, SPOE00225221-SPOE00225223, SPOE00231386-SPOE00231387, SPOE00231388-SPOE00231389,

- SPOE00232680-00232685, SPOE00226679-SPOE00226686, SPOE00226662-SPOE00226674, SPOE00226369-SPOE00226433, SPOE00228852-SPOE00228852, SPOE00232117-00232120, SPOE00227659-SPOE00227660 dhe SPOE00226185-SPOE00226190, dhe faqet në vijim të materialeve SPOE00055678-00056018 (f. SPOE00055805, SPOE00055810, SPOE00055849, dhe SPOE00055911) dhe SPOE00053263-00053359 (f. SPOE00053322) dhe U015-8743-U015-9047 (f. U015-8757-U015-8758, U015-8782, U015-8874-U015-8876 dhe U015-8878);
- c) **URDHËRON** Administratoren t'u caktojë numra të provave materiale materialeve të lartpërmendura;
- d) **REFUZON** pa paragjykim pranimin si prova jोगojore të materialeve në vijim: 058755-058755, SPOE00204138-00204138, IT-03-66 P248, 054774-01, SPOE00209434-00209512, SPOE00128571-00128954, SITF00437747-00437748, SPOE00230134-SPOE00230134, SITF00243018-00243022, SITF00243005-00243010, SITF00242993-00242999, IT-05-87 6D00067, 055828-055829, 043853-043854, SPOE00056447-SPOE00056447, 076701-076704, SITF00012041-00012044, 076693-076700, U000-8262-U000-8262, U000-2534-U000-2534, U000-1647-U000-1647, U000-1644-U000-1645, IT-03-66 P93, 097047-097056, 096746-096747, U002-3436-U002-3441, U002-2855-U002-2868, U000-8363-U000-8363, U000-2419-U000-2420, 098615-098626, U001-2310-U001-2319, U001-5195-U001-5244, U017-3349-U017-3363, U003-4775-U003-4784, SPOE00229687-SPOE00229688, SPOE00231037-SPOE00231128, SPOE00230093-SPOE00230093, SPOE00230091-SPOE00230091, SPOE00230089-SPOE00230089, dhe SPOE00232092-00232094, dhe pjesëve të mbetura të materialeve SPOE00055678-00056018, SPOE00053263-00053359 dhe U015-8743-U015-9047, që nuk janë pranuar në paragrafin paraardhës;
- e) **SHTYN** vlerësimin për materialet SPOE00053729-SPOE00053730-ET dhe

SPOE00053796-SPOE00053797-ET;

- f) **URDHËRON ZPS-në, që deri të premten, 16 qershor 2023, ora 16:00, të** përgatisë dhe dorëzojë faqet e mëposhtme të librave të mëposhtëm, në përputhje me konstatimin e bërë nga Trupi Gjykues në paragrafin 26:
- i. një dokument që përmban faqen ballinëne materialit SPOE00055678-00056018, dhe faqet SPOE00055805, SPOE00055810, SPOE00055849 dhe SPOE00055911 dhe një version të veçantë të përkthyer të tyre;
 - ii. një dokument që përmban ballinën e materialit SPOE00053263-00053359 dhe faqen SPOE00053322 dhe një version të veçantë të përkthyer të tyre; dhe
 - iii. një dokument që përmban ballinën e materialit U015-8743-U015-9047 dhe faqet U015-8757-U015-8758, U015-8782, U015-8874-U015-8876 dhe U015-8878 dhe një version të veçantë të përkthyer të tyre;
- g) **URDHËRON ZPS-në, që deri të premten, 16 qershor 2023, ora 16:00, të** parashtrojë kërkesë për ruajtjen e natyrës konfidenciale të ndonjërit prej materialeve të pranuar si prova jogojore. Përgjigjet ndaj kërkesave të dorëzohen deri **të premten, 23 qershor 2023, ora 16:00**. Trupi Gjykues nuk do të pranojë kundërpërgjigje; dhe
- h) **URDHËRON ZPS-në, që deri të premten, 16 qershor 2023, ora 16:00, të** shqyrtojë nëse mund të dorëzojë një version të redaktuar konfidencial ose të kërkojë riklasifikimin e Raportit mbi Kontrollimin dhe Sekuestrimin e Kryer ndaj Krasniqit.

/nënshkrimi/

Gjykatës Çarls L. Smith, III

Kryegjykatës

E premte, 9 qershor 2023

Në Hagë, Holandë.